<p>subjekt të varur, në formën e shoqërisë aksionare.</p> <p>2. Shndërrimi i degës së siguruesit në subjekt të varur, mund të bëhet me kërkesë të vetë siguruesit ose kur vlerësohet e nevojshme nga BQK-ja.</p> <p>3. BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi i jashtëm, që është licencuar për të operuar në një ose më shumë degë në Kosovë, që ta shndërrojë degën në subjekt të varur të siguruesit të jashtëm nëse:</p> <p>3.1. ekziston ndonjë ndryshim material në pronësinë apo menaxhmentin e siguruesit të jashtëm për të cilën BQK-ja ka arsye të bazuara për shqetësim;</p> <p>3.2. ekziston rënie materiale në gjendjen financiare të siguruesit të jashtëm apo i nënshtrohet sanksioneve nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë, për shkelje materiale të ligjit ose praktikave të pasigurta dhe të pamatura;</p> <p>3.3. konsideron se operacionet e degës së siguruesit të jashtëm në Kosovë, mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit të sigurimeve ose mund të jenë të dëmshme për interesin e policëmbajtësve;</p>	<p>entity, in the form of a joint stock company.</p> <p>2. Transforming the branch of insurer into dependent successor, can be made upon request of the insurer or when deemed necessary by the CBK.</p> <p>3. The CBK may require from the foreign insurer which is licensed to operate in one or more branches in Kosovo, to turn its branch into a dependent entity of foreign insurer if:</p> <p>3.1. there is any material change in the ownership or management of foreign insurer to which the CBK has reasonable grounds for concern;</p> <p>3.2. there is a material decline in the financial condition of foreign insurers or it is subject to sanctions by the responsible supervisory authority of the home country, for material violations of law or unsafe and irresponsible practices;</p> <p>3.3. considers that the branch operations of foreign insurer in Kosovo could jeopardize the financial stability of the insurance sector or may be harmful to the interests of policyholders;</p>	<p>formi akcionarskog društva.</p> <p>2. Konverzija filijala osiguratelja u zavisni subjekat, može se izvršiti na zahtev osiguratelja ili kada CBK proceni da je potrebno.</p> <p>3. CBK može da zahteva od stranog osiguratelja, koji je licenciran za operiše u jednoj ili više grana na Kosovu, da pretvori filijalu u zavisni subjekat stranog osiguratelja, ako:</p> <p>3.1. postoji bilo kakva materijalna promena u vlasništvu ili u upravljanju stranog osiguratelja za koje CBK ima opravdane razloge za zabrinutost;</p> <p>3.2. postoji materijalni pad u finansijskom stanju spoljnog osiguratelja ili podleže sankcijama od strane Nadležnog nadzornog organa matične zemlje odgovornih za materijalno kršenje zakona ili nesigurnih i nezrelih praksi;</p> <p>3.3. smatra da poslovanje filijala stranog osiguratelja na Kosovu može da ugrozi finansijsku stabilnost sektora osiguranja ili može biti štetno za interese osiguranika;</p>
---	--	--

<p>3.4. konsideron se mbikëqyrja nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë është joadekuate, dhe;</p> <p>3.5. për arsye të menaxhimit të rrezikut.</p> <p>4. BQK-ja mund të nxjerr rregullore në lidhje me shndërrimin e degëve të siguruesve të jashtëm në subjekte të varura.</p> <p>5. Procedura për shndërrim të degës së siguruesit të jashtëm në subjekt të varur, zhvillohet njësoj sikurse tek aplikimi për licencë të një siguruesi, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, me përjashtim të procedurës së miratimit paraprak, e cila nuk aplikohet në këto raste.</p> <p>6. Vendimi për shndërrimin e degës së siguruesit të jashtëm, kur shndërrimi kërkohet nga siguruesi i jashtëm, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i atij siguruesi.</p> <p>7. Në rastin kur siguruesi kërkon që degën ta shndërrojë në subjekt të varur, siguruesi duhet ta marrë edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit të tij.</p> <p>8. Pas aprovimit të shndërrimit dhe lëshimit të</p>	<p>3.4. considers that the supervision of the responsible supervisory authority of the home country is inadequate, and;</p> <p>3.5. for risk management reasons.</p> <p>4. The CBK may issue regulations regarding conversion of branches of foreign insurers into a dependent entity.</p> <p>5. The procedure for conversion of foreign insurer's subsidiary into a dependent entity is the same place as the application for the license of an insurer, in accordance with the provisions of this Law, with the exception of the prior approval procedure, which does not apply in those cases.</p> <p>6. The decision to convert the external branch of the insurer, when the foreign insurer requires conversion, should be taken by the General Assembly or other competent authority of that insurer.</p> <p>7. In the case where a foreign insurer requires the conversion into a dependent entity, the insurer must take the written consent of the Supervisory Authority of its country.</p> <p>8. After the approval of the conversion and</p>	<p>3.4. smatra da nadzor Nadzornog organa matične zemlje neadekvatan, I;</p> <p>3.5. zbog upravljanja rizikom.</p> <p>4. CBK može da izdaje uredbe u vezi pretvaranja filijala stranog osiguratelja u zavisne subjekte.</p> <p>5. Procedura za konverziju filijala stranog osiguratelja u zavisni subjekat vrši se isto kao i kod aplikacije za licencu od strane osiguratelja, u skladu sa odredbama ovog zakona, sa izuzetkom postupka predhodnog odobravanja, koji se ne primenjuje u ovim slučajevima.</p> <p>6. Odluku za konverziju filijale stranog osiguratelja, kada se konverzija traži od stranog osiguratelja, treba da donese generalna skupština ili drugi nadležni organ tog osiguratelja.</p> <p>7. U slučaju kada osiguratelj zahteva da pretvori filijalu u zavini subjekat, osiguratelj mora dobiti i pismenu saglasnost Nadzornog organa svoje države.</p> <p>8. Nakon usvajanja pretvaranja i izdavanja</p>
---	--	--

<p>licencës së re, të gjitha të drejtat dhe obligimet e degës së siguruesit të jashtëm, i kalojnë subjektit të varur pasardhës.</p> <p>9. Subjekti pasardhës duhet t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrin e bizneseve dhe tek organet tjera.</p> <p>10. Subjekti pasardhës duhet t'i informojë policëmbajtësit për shndërrimin, duke i njoftuar se është pasardhëse e degës së siguruesit të jashtëm dhe se ky shndërrim nuk do të ketë kurrfarë pasoja për ata.</p> <p>11. Një njoftim për publikun lidhur me shndërrimin do të publikohet për pesë (5) ditë me radhë, në media për informim të publikut, që mbulojnë tërë territorin e Republikës së Kosovës, me shpenzimet e subjektit të varur pasardhës.</p>	<p>issuance of the new license, all rights and obligations of a branch of the foreign insurer are transferred to the successor entity.</p> <p>9. The successor entity must make the necessary changes in the businesses registry and other bodies.</p> <p>10. The successor entity must inform policyholders for the conversion, by announcing that it is the successor to the branch of the foreign insurer, and that this transformation will not have any consequences for them.</p> <p>11. A public notice regarding the conversion will be published for five (5) days, in media for public information, covering the entire territory of the Republic of Kosovo, on the expenses of the dependent successor entity.</p>	<p>nove licence, sva prava i obaveze filijale stranog osiguratelja prebacuju se na sukcesorni zavisni subjekat.</p> <p>9. Sukcesorni subjekat mora izvršiti neophodne promene u registru preduzeća i kod drugih organa.</p> <p>10. Sukcesorni subjekat mora da obavesti osiguranike o konverziji, obaveštavajući ih da je naslednik filijale stranog osiguratelja, a da ova konverzacija neće imati nikakvih posledica po njih.</p> <p>11. Javni oglas o konverziji će biti objavljen pet (5) dana za redom, u dva medija za informisanje javnosti, koji pokrivaju celu teritoriju Republike Kosovo, o trošku sukcesornog zavisnog subjekta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Revokimi i Licencës</b></p> <p>1. Licenca e një siguruesi mund të revokohet me vendim të BQK-së, për një apo më shumë prej arsyeve në vijim:</p> <p>1.1. nëse BQK-ja ka miratuar planin që siguruesi të përfundojë veprimtarinë në Kosovë dhe siguruesi i është përmbajtur atij</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Revocation of License</b></p> <p>1. An insurer's license may be revoked by the decision of the Central Bank, for one or more of the following reasons:</p> <p>1.1. if the CBK has approved a plan to end the insurer operations in Kosovo and the insurer has complied with that plan;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Oduzimanje Licence</b></p> <p>1. Licenca osigurastelja može se oduzeti odlukom CBK, zbog jednog ili više sledećih razloga u nastavku:</p> <p>1.1. ako je CBK odobrila plan da osiguratelj okonča poslovanje na Kosovu i osiguratelj se pridržavao tog plana;</p>

<p>plani;</p> <p>1.2. nëse sipas vlerësimit të BQK-së, siguruesi është angazhuar në praktika të pasigurta ose jo të shëndosha;</p> <p>1.3. nëse licenca është lëshuar në bazë të informacioneve dhe dokumentacioneve të pasakta të ofruara;</p> <p>1.4. nëse siguruesi nuk ka filluar të funksionojë brenda tre (3) muajve pas marrjes së licencës apo brenda një periudhe vijuese të caktuar nga BQK-ja dhe nëse ka pushuar të merret me veprimtarinë e sigurimit për më shumë se tre (3) muaj;</p> <p>1.5. nëse një siguruesi tjetër, që mban interes të konsiderueshëm në këtë sigurues i është revokuar licenca, e që mund të ndikoj në performancën e siguruesit në Kosovë;</p> <p>1.6. nëse ka ndodhur bashkimi, shkrija ose shitja e pjesës më të madhe të pasurisë së siguruesit;</p> <p>1.7. nëse aktivitetet e siguruesit ndryshojnë në thelb nga ato të paraqitura në kërkesën për licencë dhe sipas vlerësimit të BQK-së, ky ndryshim nuk është arsyetuar e as nuk është dhënë miratimi nga BQK-ja për</p>	<p>1.2. if in the judgment of the CBK, the insurer has engaged in unsafe or unsound practices;</p> <p>1.3. if the license is issued based on incorrect information and documentation;</p> <p>1.4. if the insurer has not commenced operations within three (3) months after receiving the license or within a certain period given by the CBK or has ceased to engage in the business of insurance for more than three (3) months;</p> <p>1.5. if the license of another insurer, which holds considerable interest in the insurer, has been revoked, which may affect the performance of insurer in Kosovo;</p> <p>1.6. if there was a merger, consolidation or sale of substantial assets of the insurer;</p> <p>1.7. if the activities of insurers differ substantially from those presented in the license application, and according to the Central Bank, this change is not justified, nor approval has been given by the CBK to</p>	<p>1.2. ako prema proceni CBK, osiguratelj je angažovan u nesigurnu ili nezdravu praksu;</p> <p>1.3. ako je licenca izdata na osnovu pruženih netačnih podataka i dokumentacije;</p> <p>1.4. ako osiguratelj nije počeo sa radom u roku od tri (3) meseca nakon prijema licence ili u određenom periodu određenom od strane CBK ili ako je prestaoda se bavi poslom osiguranja više od tri (3) meseca;</p> <p>1.5. ako je oduzeta licenca nekom drugom osiguratelju koji ima značajan interes u ovom osiguratelju, što može da utiče na učinak osiguratelja na Kosovu;</p> <p>1.6. ako se dogodilo sjedinjenje, spajanje ili prodaja većinskog dela imovine osiguratelja;</p> <p>1.7. ako se aktivnosti osiguratelja bitno razlikuju od onih predstavljeni u zahtevu za izdavanje licence i, prema podacima CBK, ove promene nisu opravdane, niti je dato odobrenje od strane CBK za takve promene;</p>
--	--	---



<p>ndryshimet e tilla;</p> <p>1.8. nëse i licencuari është një degë e siguruesit të jashtëm dhe siguruesi i jashtëm e ka humbur të drejtën për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në vendin ku është vendosur drejtoria e saj qendrore; apo</p> <p>1.9. nëse ka pasur ndryshim në aksionarët kryesorë pa miratimin e BQK-së siç kërkohet me këtë Ligj.</p> <p>2. Licenca revokohet me vendim të BQK-së edhe nëse ajo konstaton se siguruesi është josolvent.</p> <p>3. Vendimi i BQK-së për të revokuar licencën i komunikohet me shkrim siguruesit, duke dhënë arsyet e vendimit.</p> <p>4. Vendimi për të revokuar një licencë nga BQK-ja, publikohet në një apo më tepër mjete të informimit për publikun.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Kërkesat për zgjerim të veprimtarisë nga siguruesit</b></p> <p>1. Siguruesi, i cili ka marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit dhe që kërkon të ushtrojë veprimtari</p>	<p>such changes;</p> <p>1.8. if the licensee is a subsidiary of foreign insurer and foreign insurer lost the right to engage in insurance activities in the home country where its head office is located, or</p> <p>1.9. if there are changes in the main shareholders without the approval of the CBK as required by this Law?</p> <p>2. The license is revoked by the CBK decision if it is determined that the insurer is insolvent.</p> <p>3. The CBK's decision to revoke the license of the insurer is done by written notification, stating the reasons for the decision.</p> <p>4. The decision to revoke a license by the CBK will be published in one or more public information means.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Requests for expansion of activities by insurer</b></p> <p>1. The insurer, which has a license to conduct certain classes of insurance and requests the exercise of activities in other classes of</p>	<p>1.8. ukoliko je korisnik licence filijala stranog osiguratelja i strani osiguratelj je izgubio pravo na obavljanje poslova osiguranja u zemlji u kojoj se nalazi njegovo glavno sedište, ili</p> <p>1.9. ako je bilo promena u glavnim akcionarima bez odobrenja CBK-a u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>2. Licenca se oduzima odlukom CBK, ako CBK utvrdi da je osiguratelj nesolventan.</p> <p>3. Odluka CBK o oduzimanju licence komunicira se osiguratelju u pisanoj formi, navođenjem razloga za odluku.</p> <p>4. Odluka o oduzimanju dozvole od CBK se objavljuje u jednim ili više sredstava javnog informisanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Zahtevi za proširenje aktivnosti od strane osiguratelja</b></p> <p>1. Osiguratelj koji je dobio dozvolu za obavljanje određene vrste osiguranja i zahteva da proširi aktivnost u drugim vrstama</p>
--	---	--

<p>në klasa të tjera të sigurimit, duhet të marrë licencë për zgjerim veprimtarie për klasat që dëshiron të licencohet.</p> <p>2. BQK-ja mund të nxjerr rregullore për kriteret dhe afatet për shqyrtimin e kërkesave për zgjerim të veprimtarisë së siguruesve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Informimi për fillimin apo ndërprerjen e veprimtarisë së siguruesit</b></p> <p>Siguruesi informon menjëherë BQK-në për fillimin apo ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit për klasën e caktuar të sigurimit, për të cilën ka marrë licencë në përputhje me këtë Ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI III</b> <b>KËRKESAT PËR KAPITALIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Kapitali themeltar</b></p> <p>1. Kapitali themeltar i të gjithë siguruesve të licencuar për ushtrimin e aktivitetit sigurues në Kosovë për sigurimet jo-jetë nuk mund të jetë më i ulët se 2,200,000 (dy milion e dyqind mijë) euro. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të nenit 7 të këtij Ligji, atëherë kapitali themeltar nuk mund</p>	<p>insurance, must obtain a license for activity expansion for classes that wants to be licensed.</p> <p>2. The CBK may issue regulation on the criteria and deadlines for processing requests for extension of insurers activities.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Information about the initiation or cessation of insurer's activity</b></p> <p>The insurer immediately informs the CBK for starting or cessation of the insurance operations for the specific class of insurance, for which it is licensed in accordance with this Law.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER III</b> <b>REQUIREMENTS FOR CAPITAL</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Charter Capital</b></p> <p>1. The charter capital of all insurers licensed to conduct insurance activity in Kosovo for non-life insurance may not be lower than EUR 2,200,000 (two million and two hundred). In the case where one or several risks are included in classes 10 to 15 of Article 7 of this Law, the charter capital may not be less than</p>	<p>osiguranja, mora da dobije dozvolu za proširenje delatnosti za vrste za koje želi da bude licenciran.</p> <p>2. CBK može izdati uredbu za kriterijume i rokove za razmatranje zahteva o proširenju aktivnosti osiguratelja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Informacije o pokretanju ili prestanku aktivnosti osiguratelja</b></p> <p>Osiguratelj odmah obaveštava CBK da pokretanje ili prestanak obavljanja aktivnosti osiguranja za određenu vrstu osiguranja, za koju je dobio licencu u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III</b> <b>ZAHTJEVI ZA KAPITAL</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Osnovni kapital</b></p> <p>1. Osnivački kapital svih licenciranih osiguratelja za obavljanje delatnosti osiguranja na Kosovu za neživotna osiguranja ne može biti manji od 2.200.000 (dva miliona i dvije stotine) evra. U slučaju kada jedan ili nekoliko rizika uključeni u vrste od 10 do 15, člana 7. ovog zakona, osnovni kapital ne može biti</p>
---	--	--

<p>të jetë më i ulët se 3,200,000 (tre milion e dyqindmijë) euro.</p> <p>2. Përveç kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, siguruesi duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) e kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>3. Aksionarët depozitojnë për llogari të siguruesit vlerën përkatëse në para të gatshme të kapitalit themeltar dhe fondin për shpenzimet fillestare të parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, në një llogari të besuar, në një nga bankat e licencuara në Republikën e Kosovës. Kapitali sipas paragrafit (1) të këtij neni paguhet plotësisht përpara marrjes së licencës përfundimtare.</p> <p>4. Kapitali i themeltar i siguruesit nuk mund të përdoret si kolateral për të marrë kredi apo për ndonjë aktivitet tjetër të siguruesit.</p>	<p>EUR 3,200,000 (three million and two hundred thousands).</p> <p>2. Besides capital, as defined in paragraph 1 of this Article, the insurer must have an additional fund for initial expenses to cover the costs of establishment, operation and management, which in any case should not be less than twenty percent (20%) of capital specified in paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. Shareholders deposit on behalf of insurers corresponding value in cash of the capital and the fund for initial expenses as provided for in paragraph 2 of this Article, in a trust account in one of the banks licensed in the Republic of Kosovo. The capital under paragraph (1) of this section shall be paid fully before receiving final approval.</p> <p>4. The charter capital of the insurer cannot be used as collateral to obtain loans or for any other activity of the insurer.</p>	<p>manji od 3.200.000 (tri miliona i dvije stotine) evra.</p> <p>2. Pored osnivačkog kapitala, kao što je definisan u paragrafu 1. ovog člana, osiguratelj mora imati i dodatni fond za početne troškove za pokrivanje troškova osnivanja, poslovanja i upravljanja, koji u svakom slučaju ne bi trebalo da bude manji od dvadeset procenata (20 %) od osnivačkog kapitala određenog paragrafom 1. ovog člana.</p> <p>3. Akcionari deponuju u ime osiguratelja odgovarajuću vrednost u gotovom novcu osnivačkog kapitala i fonda za početne troškove predviđene u paragrafu 2 ovog člana, u proverenom računu, u nekoj od licenciranih banaka u Republici Kosovo. Kapital po paragrafu (1) ovog člana će biti u potpunosti isplaćen pre prijema konačne licence.</p> <p>4. Osnivački kapital osiguratelja ne može da se koristi kao kolateral za dobijanje kredita ili za bilo koju drugu aktivnost osiguratelja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Burimet e Kapitalit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Sources of Capital</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Izvori Kapitala</b></p>
<p>1. Aksionarët e siguruesit i japin BQK-së informacion për burimin e kapitalit minimal të</p>	<p>1. The shareholders of insurers, will provide the CBK with information on the source of the</p>	<p>1. Akcionari osiguratelja daju informacije CBK o izvoru minimalnog kapitala plaćenog za</p>

<p>paguar për themelimin e siguruesit, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së siguruesit.</p> <p>2. Për të vërtetuar burimin e parave për kapitalin minimal dhe shtesën e këtij kapitali në BQK, dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:</p> <p>2.1. për personat juridikë:</p> <p>2.1.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të siguruesit;</p> <p>2.2.1. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.</p> <p>2.2. për personat fizikë:</p> <p>2.2.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;</p> <p>2.2.2. vërtetime që dëshmojnë</p>	<p>minimum paid up capital for the establishment of the insurer, as well as any additional capital during the exercise of activities of the insurer.</p> <p>2. To prove the source of money for minimum capital and the addition of this capital, the following documentation will be submitted to the CBK:</p> <p>2.1. for legal entities:</p> <p>2.1.1. evidence of the source of capital formation, such as the report of the independent external auditor, the annual financial statements, gifts or other sources intended for use in the purchase of shares of the insurer;</p> <p>2.2.1. certificate issued by the competent authorities, which provides data for the balance of the legal entity and the fulfillment of tax obligations.</p> <p>2.2. for individuals:</p> <p>2.2.1. evidence of the source of capital formation, such as purchase or sale, gifts, wages, money in bank deposits or other proof of the source of capital formation;</p> <p>2.2.2. certificates evidencing the</p>	<p>osnivanje osiguratelja, kao i za bilo koji dodatni kapital tokom obavljanja poslovanja osiguratelja.</p> <p>2. Da bi dokazavao izvor novca minimalnog kapitala i dodatnog kapitala u CBK se podnosi sledeća dokumentacija:</p> <p>2.1. za pravna lica:</p> <p>2.1.1. evidencija o izvoru formiranja kapitala, kao i izveštaj nezavisnog spoljnog revizora, godišnji finansijski izveštaj, pokloni ili drugi izvori namenjeni da se upotrebe u kupovinu akcija osiguratelja;</p> <p>2.2.1. potvrda izdata od strane nadležnih organa, koji daje podatke o bilansu pravnog lica i ispunjavanju poreskih obaveza.</p> <p>2.2. za fizička lica:</p> <p>2.2.1. evidencija o izvoru formiranja kapitala kao kupovina ili prodaja, pokloni, plate, novčani depoziti u bankama, ili drugi dokazi o izvoru formiranja kapitala;</p> <p>2.2.2. potvrde kojima se dokazuje</p>
---	--	--

<p>përmbushjen e detyrimeve tatimore.</p> <p>2.2.3. kontributet për kapitalin e siguruesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare dhe hua të tjera që rrjedhin nga fonde, origjina e të cilave është e paligjshme.</p> <p>3. Me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, BQK-ja mund të bashkëpunojë me Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës apo me ndonjë autoritet tjetër të lëmisë së zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. BQK-ja mund të kërkojë informacione shtesë nga aksionarët gjatë verifikimit të burimit të kapitalit.</p> <p>4. Nëse prejardhja e kapitalit themeltar nuk është e qartë për BQK-në, kjo përbën bazë për refuzim të licencës.</p> <p>5. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore në zbatim të dispozitave të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Ekuiteti</b></p> <p>1. Siguruesit janë të obliguar që gjatë periudhave të raportimit financiar, niveli i ekuitetit nuk mund të jetë më pak se kapitali</p>	<p>fulfillment of tax obligations;</p> <p>2.2.3. contributions for insurers capital must not derive from borrowed funds from the public, bank loans and other loan derived from funds whose origin is illegal.</p> <p>3. In order to prevent money laundering, the CBK may cooperate with the Financial Intelligence Unit of Kosovo or any other authority in the area of law enforcement in the Republic of Kosovo. The CBK may request additional information from shareholders during the verification of the source of capital.</p> <p>4. If the origin of capital is not clear to the CBK, this constitutes grounds for denial of the license.</p> <p>5. CBK may issue regulations to implement the provisions of this article.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Equity</b></p> <p>1. Insurers are obliged ensure that during financial reporting periods, the level of equity cannot be less than the charter capital.</p>	<p>ispunjenje poreskih obaveza;</p> <p>2.2.3. doprinosi za kapital osiguratelja ne moraju da proizlaze iz pozajmljenih sredstava od javnosti, bankarskih kredita i drugih kredita koji potiču iz fondova čije je poreklo nezakonito.</p> <p>3. U cilju sprečavanja pranja novca, CBK može saradivati sa Finansijskom obaveštajnom jedinicom Kosova ili bilo kojim drugim organom u oblasti zakona u Republici Kosovo. CBK može da zatraži dodatne informacije od akcionara u toku verifikacije izvora kapitala.</p> <p>4. Ako za CBK poreklo kapitala nije jasno, ovo predstavlja osnovu za odbijanje licence.</p> <p>5. CBK može da donese Uredbe za sprovođenje odredaba ovog člana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Kapital</b></p> <p>1. Osiguratelji se obavezuju da tokom perioda finansijskog izveštavanja, nivo kapitala ne može biti manji od osnivačkog kapitala.</p>
--	---	--

<p>themeltar.</p> <p>2. Në rast se niveli i ekuitetit bie nën nivelin e kapitalit themeltar, atëherë aksionari është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditëve të shtojë kapital shtesë me qëllim të mbulimit të humbjes.</p> <p><b>KAPITULLI IV QEVERISJA E SIGURUESVE DHE RISIGURUESVE</b></p> <p><b>Neni 22 Organizimi i siguruesve</b></p> <p>1. Siguruesit do të themelohen si shoqëri aksionare dhe regjistrohen në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve, në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe pronësinë e shoqërisë aksionare, që gjenden në Ligjin përkatës për shoqëritë tregtare, të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë Ligj, zbatohen edhe për siguruesit. Ky Ligj mbizotëron rreth vendosjes se cilat dispozita duhet të zbatohen për siguruesit.</p>	<p>2. If the level of equity falls below the level of capital, the shareholder is obliged within 15 days to add additional capital in order to cover the loss.</p> <p><b>CHAPTER IV GOVERNANCE OF INSURERS</b></p> <p><b>Article 22 The organization of insurers</b></p> <p>1. Insurers will be established as a joint stock company and registered at the Business Registration Agency, in accordance applicable legislation.</p> <p>2. All provisions related to the governance and ownership of a joint stock company, occurring in the respective Law on Commercial Companies, which are not inconsistent with this Law, are applied to insurers. This law prevails when deciding which provisions should apply to insurers.</p>	<p>2. Ako nivo kapitala padne ispod nivoa osnivačkog kapitala, akcionar je dužan da u roku od 15 dana doda dodatni kapital kako bi pokrio gubitak.</p> <p><b>POGLAVLJE IV UPRAVLJANJE OSIGURATELJA</b></p> <p><b>Član 22 Organizovanje osiguratelja</b></p> <p>1. Osiguratelji će biti osnovani kao akcionarsko društvo i registrovani kod Agencije za registraciju privrednih subjekata, u skladu sa važećim Zakonodavstvom.</p> <p>2. Sve odredbe koje se odnose na upravljanje i vlasništvo akcionarskog društva, koje se nalaze u relevantnom Zakonu o poslovnim društvima, koje nisu u suprotnosti sa ovim Zakonom, primenjuju se i za osiguratelje. Ovaj zakon preovlađuje o odlučivanju koje odredbe treba da se primenjuju na osiguratelje.</p>
---	--	---

<p align="center"><b>Neni 23</b> <b>Akti i Themelimit dhe Statuti</b></p>	<p align="center"><b>Article 23</b> <b>Constitutive Act and Statute</b></p>	<p align="center"><b>Član 23</b> <b>Konstitutivni Akt i Statut</b></p>
<p>1. Të gjithë siguruesit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në Kosovë, duhet ta kenë aktin e themelimit dhe statutin, një kopje e të cilave duhet të miratohet nga BQK-ja. Asnjë sigurues, përveç degës së siguruesit të jashtëm të licencuar në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e saj të themelimit dhe statutin pa miratimin paraprak me shkrim të BQK-së.</p> <p>2. Dega e siguruesit të jashtëm e licencuar në Kosovë, duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e saj të themelimit, statutin apo në dokumentacionin ekuivalent të themelimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.</p> <p>3. Çdo sigurues, përfshirë degën e siguruesit të jashtëm, mban në BQK, një kopje të vërtetuar të aktit të themelimit apo dokumentacionit ekuivalent të themelimit, statutin dhe listën e zyrtarëve të siguruesit, bashkë me ekzemplarin e nënshkrimeve dhe përshkrimin e kompetencave të tyre.</p>	<p>1. All insurance providers which operate in Kosovo should have a founding act and statute, a copy of which must be approved by the CBK. No insurer, except the branch of foreign insurers licensed in Kosovo, can change its founding act and the statute without the prior written approval of the CBK.</p> <p>2. The branch of foreign insurers licensed in Kosovo, must notify the CBK regarding any change in its founding act, the statute or equivalent documentation of establishment within thirty (30) days from the effective date of any change.</p> <p>3. Every insurer, including the branch of foreign insurers keeps in the CBK, a certified copy of the founding act or equivalent documentation, the statute and a list of officers of insurers, together with specimen signatures and a description of their powers.</p>	<p>1. Svi osiguratelji koji obavljaju posao osiguranja na Kosovu, trebalo bi da imaju konstitutivni akt i statut, i jedna od tih kopija mora biti odobrena od strane CBK. Nijedan osiguratelj, osim filijale stranih osiguratelja licenciranih na Kosovu, ne može promeniti svoj konstitutivni akt i statut bez prethodnog pismenog odobrenja od strane CBK.</p> <p>2. Filijala stranog osiguratelja licenciranog na Kosovu, mora obavestiti CBK za svaku promenu u svom konstitutivnom aktu, statutu ili ekvivalentnoj dokumentacijiosnivanja u roku od trideset (30) dana od dana stupanja na snagu bilo kakve promene.</p> <p>3. Svaki osiguratelj, uključujući filijalu stranog osiguratelja drži u CBK overenu kopiju akta o osnivanju ili ekvivalentnu dokumentaciju osnivanja, statuta i spiska službenika osiguratelja, zajedno sa uzorkom potpisa i opisom njihovih ovlašćenja.</p>

<p align="center"><b>Neni 24</b> <b>Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur</b></p>	<p align="center"><b>Article 24</b> <b>Requirements for adequacy and appropriateness</b></p>	<p align="center"><b>Član 24</b> <b>Zahtevi adekvatnost i prikladnost</b></p>
<p>1. Çdo aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë si dhe aktuari i siguruesit duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës dhe kërkohet të aprovohet nga BQK-ja.</p> <p>2. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për të mbajtur pozicionin përkatës te siguruesi, bazuar në kriteret e mëposhtme:</p> <p>2.1. historiku penal;</p> <p>2.2. integriteti, ndershmëria dhe përkushtimi në përmbushjen e detyrave të tij;</p> <p>2.3. kompetenca, aftësi profesionale dhe gjykimi i shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tij;</p> <p>2.4. pavarësia në mënyrë që të mos cenohen interesat e siguruesit nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.</p> <p>3. Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur</p>	<p>1. Every major shareholder, director, senior manager and actuary of the insurer shall meet the requirements for adequacy and appropriateness, regarding the respective position, and is required to be approved by the CBK.</p> <p>2. The CBK assesses whether a person is adequate and appropriate to hold the corresponding position to the insurer based on the following criteria:</p> <p>2.1. criminal history</p> <p>2.2. integrity, honesty and dedication in fulfilling his duties;</p> <p>2.3. competence, professional skills and sound judgment in the performance of his duties;</p> <p>2.4. independence in order not to violate the interests of the insurer's from the conflict of interest that may arise while on duty.</p> <p>3. Requirements for adequacy and</p>	<p>1. Svaki glavni akcionar, direktor, viši rukovodilac kao i aktuar osiguratelja mora da ispuni uslove za adekvatnost i prikladnost u vezi odgovarajućeg pozicioniranja, i zahtev treba da se odobri od strane CBK.</p> <p>2. CBK procenjuje da li je neka osoba adekvatna i prikladna da ima određenu poziciju kod osiguratelja na osnovu sledećih kriterijuma:</p> <p>1.4. krivični istorijat;</p> <p>2.2. integritet, poštenje i posvećenost u ispunjavanju svojih dužnosti;</p> <p>2.3. nadležnost, profesionalne veštine i zdrava presuda u obavljanju svojih dužnosti;</p> <p>2.4. nezavisnost kako ne bi ugrožavala interese osiguratelja sukobom interesa koji mogu nastati dok obavlja dužnosti.</p> <p>3. Zahtevi za adekvatnost i prikladnost treba da</p>



<p>duhet të aplikohen nga personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni gjatë gjithë kohës.</p> <p>4. BQK-ja mund të rregullojë dhe caktojë edhe kritere tjera për vlerësimin e përshtatshmërisë së personave nga ky nen.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Organet siguruesve</b></p> <p>1. Organet e siguruesve janë:</p> <p>1.1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve;</p> <p>1.2. Bordi i drejtorëve; dhe</p> <p>1.3. Menaxhmenti i lartë.</p>	<p>appropriateness should be applied by persons specified in paragraph 1 of this article all the time.</p> <p>4. The CBK can adjust and set the criteria for the evaluation of persons appropriateness from this article.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Insurers bodies</b></p> <p>1. Bodies of insurers are:</p> <p>1.1. The general assembly of shareholders;</p> <p>1.2. Board of Directors, and</p> <p>1.3. Senior Management.</p>	<p>se primenjuju od strane lica određenih u paragrafu 1. ovog člana sve vreme.</p> <p>4. CBK može urediti i postaviti druge kriterijume za procenu pogodnosti osoba iz ovog člana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Organi osiguratelja</b></p> <p>1. Organi osiguratelja su:</p> <p>1.1. Generalna Skupština akcionara;</p> <p>1.2. Upravni odbor; i</p> <p>1.3. Viši uprava.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Asambleja e përgjithshme e aksionarëve</b></p> <p>1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të siguruesit përbëhet nga të gjithë aksionarët.</p> <p>2. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve mbahet së paku një herë në vit ose me shpesh sipas kërkesës së aksionarëve, bordit të drejtorëve apo me urdhër të BQK-së.</p> <p>3. Bordi i drejtorëve, përveç rasteve kur</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>The general assembly of shareholders</b></p> <p>1. The General Assembly of Shareholders of the insurer consists of all shareholders.</p> <p>2. The meeting of the General Assembly of Shareholders is held at least once a year or more frequently at the request of shareholders, Board of Directors or upon the order of the CBK.</p> <p>3. Board of Directors, unless otherwise</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Generalna Skupština akcionara</b></p> <p>1. Generalna Skupština akcionara osiguratelja se sastoji od svih akcionara.</p> <p>2. Generalna Skupština akcionara se održava najmanje jednom godišnje ili češće na zahtev akcionara, upravnog odbora ili po naredbi CBK.</p> <p>3. Upravni odbor, osim ako nije drugačije</p>

<p>parashihet ndryshe me këtë Ligj, thërret asamblenë e përgjithshme të aksionarëve.</p> <p>4. Çdo aksionar i cili është vendosur në listën e aksionarëve në regjistër, tridhjetë (30) ditë para datës së seancës së asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, ka të drejtë vote në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve.</p> <p>5. Siguruesi mbulon shpenzimet e seancës të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve.</p> <p>6. Kërkesa për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve mund të paraqitet nga:</p> <p>6.1. aksionari ose grupi i aksionarëve me më shumë se dhjetë përqind (10%) të numrit të përgjithshëm të aksioneve me të drejtë vote;</p> <p>6.2. së paku dy (2) anëtarë të bordit të drejtorëve;</p> <p>6.3. Komiteti i auditimit;</p> <p>7. Kërkesa për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, me propozimin për rendin e ditës, i dorëzohet bordit të drejtorëve në formë të shkruar.</p> <p>8. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve të</p>	<p>provided by this Law, convenes the General Assembly of Shareholders.</p> <p>4. Each shareholder, who is placed in the list of shareholders on the register thirty (30) days prior to the meeting of the General Assembly of Shareholders, is entitled to vote at the general meeting of shareholders.</p> <p>5. The insurer covers the cost of the session of the General Assembly of Shareholders.</p> <p>6. The request for calling the meeting of the General Assembly of Shareholders may be submitted by:</p> <p>6.1. shareholder or group of shareholders with more than ten percent (10 %) of the total number of shares with voting rights;</p> <p>6.2. at least two (2) members of the Board of Directors;</p> <p>6.3 . Audit Committee;</p> <p>7. The request for calling the meeting of the General Assembly of Shareholders with the proposed agenda, is submitted to the Board of Directors in writing.</p> <p>8. The general meeting of shareholders of the</p>	<p>predviđeno ovim Zakonom, saziva Generalnu Skupštinu akcionara.</p> <p>4. Svaki akcionar, koji se nalazi na registarskoj listi akcionara, trideset (30) dana pre sednice Generalne Skupštine akcionara, ima pravo glasa na Generalnoj Skupštini akcionara.</p> <p>5. Osiguratelj pokriva troškove sednice Skupštine skcionara.</p> <p>6. Zahtev za raspisivanje Generalne Skupštine akcionara može se podneti od strane:</p> <p>6.1. akcionara ili grupe akcionara sa više od deset posto (10 %) od ukupnog broja akcija sa pravom glasa;</p> <p>6.2. najmanje dva (2) člana upravnog odbora;</p> <p>6.3. Odbora za reviziju;</p> <p>7. Zahtev za raspisivanje Generalne Skupštine akcionara, sa predlogom o dnevnom redu, dostavlja se upravnom odboru u pisanoj formi.</p> <p>8. Generalni sastanak akcionara osiguratelja</p>
--	--	--

<p>siguruesit merr vendime për:</p> <p>8.1. krijimin e kapitalit fillestar nëpërmjet emetimit ose rritjes së aksioneve të zakonshme dhe emetimit ose rritjes së aksioneve të preferuara;</p> <p>8.2. zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit të drejtorëve;</p> <p>8.3. emrin dhe adresën e selisë qendrore të siguruesit;</p> <p>8.4. kompensimet për anëtarët e bordit të drejtorëve;</p> <p>8.5. emëron auditorin e jashtëm, dhe</p> <p>8.6. raportet vjetore financiare me raportin e auditorit të jashtëm;</p> <p>8.7. vendime tjera siç përcaktohet me statutin e siguruesit.</p> <p>9. Aspektet tjera të asamblesë së përgjithshme të aksionareve qeverisen sipas ligjit në fuqi për shoqëritë tregtare, për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji.</p>	<p>insurer makes decisions about:</p> <p>8.1. establishment of initial capital through emission and increase of common shares and emission or increased of preferred shares;</p> <p>8.2. the selection and dismissal of members of the Board of Directors;</p> <p>8.3. name and address of the insurer's headquarters;</p> <p>8.4. compensation for the members of the Board of Directors;</p> <p>8.5. appointment of the external auditor, and;</p> <p>8.6. annual financial reporting of the external auditor;</p> <p>8.7. other decisions, as defined by the statute of insurers.</p> <p>9. Other aspects of the General Assembly of Shareholders will be governed by the applicable Law on Commercial Companies, to the extent not inconsistent with the provisions of this Law.</p>	<p>donosi odluke o:</p> <p>8.1. uspostavljanju inicijalnog kapitala putem izdavanja ili povećanja uobičajenih akcija ili povećanja preferencijalnih akcija;</p> <p>8.2. izboru i razrešenju članova Upravnog odbora;</p> <p>8.3. nazivu i adresi sedišta osiguratelja;</p> <p>8.4. naknadi za članove Upravnog odbora;</p> <p>8.5. imenovanju spoljnog revizora, i</p> <p>8.6. godišnjim finansijskim izveštajima spoljnog revizora;</p> <p>8.7. drugim odlukama, kao što je definisano statutom osiguratelja.</p> <p>9. Drugi aspekti Generalne Skupštine akcionara će biti regulisani važećim zakonom o privrednim subjektima, u meri u kojoj nisu u suprotnosti sa odredbama ovog zakona.</p>
---	--	--

<p align="center"><b>Neni 27</b> <b>Bordi i Drejtorëve</b></p>	<p align="center"><b>Article 27</b> <b>Board of Directors</b></p>	<p align="center"><b>Član 27</b> <b>Upravni Odbor</b></p>
<p>1. Bordi i drejtorëve të siguruesit përbëhet nga numri tek, jo më pak se pesë (5) anëtarë me të drejtë vote, që emërohen dhe shkarkohen nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve, me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.</p> <p>2. Përveç kryeshefit ekzekutiv, i cili sipas detyrës zyrtare është anëtar i bordit të kompanisë, të gjithë anëtarët e tjerë të bordit të drejtorëve duhet të jenë drejtor joekzekutiv,</p> <p>3. Bordi i drejtorëve zgjedh kryesuesin e tij, nga radha e njërit prej anëtarëve joekzekutiv të tij.</p> <p>3.1. kryeshefi ekzekutiv është anëtar i bordit të drejtorëve sipas detyrës zyrtare me të drejtë vote.</p> <p>3.2. çdo anëtar i bordit të drejtorëve të siguruesit, duhet që t'i plotësojë kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur nga neni 24 i këtij Ligji.</p> <p>4. Zyrtarët e lartë publik, mund të shërbejnë si anëtarë të bordit të drejtorëve të ndonjë siguruesi, duke iu nënshtuar kufizimeve të</p>	<p>1. The Board of Directors is consisted of not less than five (5) voting members who are appointed and dismissed by the General Assembly of Shareholders, with four (4) years term, re-appointment possibility.</p> <p>2. Besides the CEO, who is ex officio member of the Board of the company, all other members of the Board of Directors should be non - executive directors,</p> <p>3. The Board of Directors elects its chairperson from one of its non-executive members.</p> <p>3.1. The Chief Executive Officer is a member of the Board of Directors ex officio with voting right.</p> <p>3.2. any member of the Board of Directors of the insurer must meet the requirements for adequacy and appropriateness, as per Article 24 of this Law.</p> <p>4. Senior public officials, can serve as members of the Board of Directors of any insurer, subject to limitations prescribed by</p>	<p>1. Upravni odbor osiguratelja se sastoji od neparnog broja, najmanje pet (5) članova sa pravom glasa koje imenuje i razrešava Generalna Skupština akcionara, sa mandatom od četiri (4) godine, sa mogućnošću ponovnog izbora.</p> <p>2. Osim izvršnog direktora, koji je po službenoj dužosti pripadnik odbora kompanije, svi ostali članovi upravnog odbora trebalo bi da budu ne-izvršni direktori.</p> <p>3. Upravni odbor bira predsednika iz redova njegovih ne-izvršnih članova.</p> <p>3.1. Izvršni direktor je član Upravnog odbora po službenoj dužnosti sa pravom glasanja.</p> <p>3.2. svaki član upravnog odbora osiguratelja, mora da ispunjava uslove za adekvatnost i prikladnost iz člana 24. ovog zakona.</p> <p>4. Visoki javni zvaničnici, mogu biti članovi upravnog odbora bilo kog osiguratelja, podvrgavajući se određenim ograničenjima sa</p>

<p>përcaktuara me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.</p> <p>5. Ky nen nuk aplikohet për degën e siguruesit të jashtëm.</p> <p>6. Anëtarët e bordit të drejtorëve i informojnë aksionarët për konfliktin e mundshëm të interesit.</p>	<p>law on the prevention of conflict of interest, in practicing of public functions.</p> <p>5. This section does not apply to the branch of foreign insurers.</p> <p>6. The members of Board of Directors shall inform the shareholders of potential conflict of interest.</p>	<p>važećim zakonodavstvom radi sprečavanja sukoba interesa, u obavljanju javne funkcije.</p> <p>5. Ovaj član se ne primenjuje na filijalu stranog osiguratelja.</p> <p>6. Članovi upravnog odbora obaveštavaju akcionare o potencijalnom sukobu interesa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Detyrat e Bordit të drejtorëve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>The Duties of Board of directors</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Dužnosti Upravnog odbora</b></p>
<p>1. Bordi i drejtorëve të siguruesit, siguron se veprimtaritë e siguruesit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore të BQK-së, si dhe rregullat dhe procedurat e brendshme të siguruesit.</p> <p>2. Pa paragjykuar ushtrimin e aktiviteteve sipas paragrafit 1. bordi i drejtorëve të siguruesit është përgjegjës:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. të aprovojë strukturën organizative të siguruesit;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. të emërojë dhe shkarkojë manaxherët e lartë të siguruesit;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. të mbikëqyrë punën e manaxherëve të</p>	<p>1. The Board of Directors of the insurer ensures that the activities of the insurer are conducted in accordance with applicable legislation, CBK by-laws and internal rules and procedures of insurers.</p> <p>2. Without prejudice to the conduct of activities under paragraph 1, the Board of Directors of the insurer is responsible for:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. approval the organizational structure of the insurer;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. appointment and dismiss senior managers of insurers;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. supervision of the work of the senior</p>	<p>1. Upravni odbor osiguratelja, obezbeđuje da se aktivnosti osiguratelja sprovode u skladu sa važećim zakonima, podzakonskim aktima CBK-a, kao i internim pravilima i procedurama osiguratelja.</p> <p>2. Bez obzira na obavljanje aktivnosti iz stava 1, Upravni odbor osiguratelja je odgovoran da:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. odobrava organizacionu strukturu osiguratelja;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. imenuje i razrešava više rukovodiocce osiguratelja;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. vrši nadzor nad radom viših</p>

<p>lartë të siguruesit;</p> <p>2.4. të aprovojë strategjinë afariste dhe buxhetin vjetor të siguruesit;</p> <p>2.5. të aprovojë politika dhe procedura, në pajtim me të cilat siguruesi ushtron aktivitetin e tij, duke përfshirë në veçanti politikat dhe procedurat lidhur me menaxhimin rrezikut;</p> <p>2.6. të krijojë politika dhe procedura për të trajtuar konfliktet e interesit dhe të sigurojë zbatimin e tyre;</p> <p>2.7. të sigurojë vendosjen, funksionalizimin, përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e sistemeve të kontroleve të brendshme dhe menaxhimin e rrezikut të siguruesit;</p> <p>2.8. të sigurojë vendosjen e funksionit të përshtatshëm të auditimit të brendshëm;</p> <p>2.9. të propozojë auditorin e jashtëm dhe pas aprovimit nga BQK-ja, i propozon asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për emërim;</p> <p>2.10. të sigurojë se siguruesi ka kryer auditimin vjetor të jashtëm, i cili përfshin mendimin e auditorit rreth vërtetësisë dhe</p>	<p>management of the insurer;</p> <p>2.4. approval of the annual budget and business strategy of the insurer;</p> <p>2.5. approval of policies and procedures, in accordance with which the insurer operates, including, in particular, policies and procedures related to risk management;</p> <p>2.6. establishing policies and procedures to address conflicts of interest and ensure their implementation;</p> <p>2.7. ensuring the establishing, functioning, adequacy and sufficiency of internal control and risk management systems of the insurers;</p> <p>2.8. ensuring appropriate setting for functioning of internal audit;</p> <p>2.9. proposal of the external auditor and after approval by the CBK, proposes appointment to the General Assembly of Shareholders;</p> <p>2.10. ensuring that the insurer has conducted annual external audit, which includes the auditor's opinion about the</p>	<p>rukovodioca osiguratelja;</p> <p>2.4. odobrava poslovnu strategiju i godišnji budžet osiguratelja;</p> <p>2.5. odobrava politike i procedure u skladu sa kojima osiguratelj posluje, uključujući naročito, politike i procedure koje se odnose na upravljanje rizikom;</p> <p>2.6. kreira politike i procedure za rešavanje sukoba interesa i osigurava njihovo sprovođenje;</p> <p>2.7. obezbeđuje primenu, funkcionisanje, adekvatnost i dovoljnost sistema internih kontrola i upravljanje rizicima osiguratelja;</p> <p>2.8. obezbeđuje primenu odgovarajuće funkcije interne revizije;</p> <p>2.9. predlaže spoljnog revizora i, nakon odobrenja od strane CBK, predlaže Generalnoj Skupštini akcionara za imenovanje;</p> <p>2.10. obezbeđuje da je osiguratelj sproveo godišnju spoljnu reviziju, koji obuhvata mišljenje revizora o autentičnosti i tačnosti</p>
--	---	---

<p>saktësisë së pasqyrave financiareve të siguruesit;</p> <p>2.11. të krijojë dhe vendosë një politikë të përshtatshme të kompensimit për menaxhmentin e lartë. Politika duhet të marrë parasysh performancën e menaxhmentit të lartë dhe siguruesit dhe nuk duhet të përfshijë stimulimet të cilat do të inkurajonin një sjellje të pamatur;</p> <p>2.12. të kryejë funksione tjera, ashtu siç përcaktohet në statutin e siguruesit;</p> <p>2.13. shqyrton pasqyrat vjetore të siguruesit, përpara se këto pasqyra të miratohen nga organet drejtuese të tij;</p> <p>2.14. shqyrton raporte tjera financiare të përcaktuara nga BQK-ja.</p>	<p>authenticity and accuracy of the financial statements of the insurer;</p> <p>2.11. creation and establishing of a suitable compensation policy for senior management. The policy should take into account the performance of senior management and the insurers and should not include incentives that would encourage reckless behavior;</p> <p>2.12. performing other functions as prescribed by the statute of insurer;</p> <p>2.13. examining insurer's statements before such statements are approved by its governing bodies;</p> <p>2.14. examining other financial reports as defined by the CBK.</p>	<p>finansijskih izveštaja osiguratelja;</p> <p>2.11. stvora i uspostavlja odgovarajuću naknadu za politiku višeg rukovodstva. Politika treba da uzme u obzir performanse višeg rukovodstva i osiguratelja i ne bi trebalo da obuhvata podsticaje koji će ohrabriti nemarno ponašanje;</p> <p>2.12. obavlja i druge funkcije kao što je propisano statutom osiguratelja;</p> <p>2.13. razmatra godišnje izveštaje osiguratelja pre nego što se ti izveštaji odobre od strane upravnih organa;</p> <p>2.14. razmatra i druge finansijske izveštaje kao što je definisano od strane CBK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Mbledhjet e Bordit të drejtorëve</b></p> <p>1. Bordi i drejtorëve mbledhet sipas nevojës, por jo më pak se një herë në tre (3) muaj.</p> <p>2. BQK-ja mund të kërkojë nga siguruksi, që të mbajë mbledhje të posaçme të bordit të drejtorëve, nëse e konsideron këtë të nevojshme, për të shqyrtuar çështjet e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Meetings of the Board of Directors</b></p> <p>1. The Board of Directors shall meet as required, but not less than once every three (3) months.</p> <p>2. The CBK may require the insurer to hold a special meeting of the Board of Directors, if it considers this necessary, to consider the issues presented, in the written, by CBK.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Sastanci Upravnog Odbora</b></p> <p>1. Upravni odbor se sastaje po potrebi, ali ne manje od jednom u tri (3) meseca.</p> <p>2. CBK može da zahteva od osiguratelja da održi poseban sastanak Upravnog odbora, ako se to smatra neophodnim, da se razmotre pitanja izneta u pismenom obliku od strane</p>

<p>paraqitura me shkrim nga BQK-ja.</p> <p>3. Vendimet e bordit të drejtorëve janë valide kur janë të pranishëm dhe votojnë shumica e anëtarëve të tij.</p> <p>4. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave, të së paku shumicës së anëtarëve të pranishëm që përbejnë kourumin, me përjashtim të rasteve kur në statutin e siguruesit kërkohet një shumice më e lartë për marrjen e vendimeve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Komitetet e Bordit të Drejtorëve</b></p> <p>1. Bordi i drejtorëve duhet të themelojë komitetin e auditimit, komitetin për menaxhimin e rrezikut dhe komitetin për menaxhim të investimeve.</p> <p>2. Siguruesi mund të themelojë edhe komitete tjera sipas vlerësimit të tij. BQK-ja në kuadër të kompetencave të saj, mund të kërkojë nga siguruesi të themelojë komitete të posaçme.</p> <p>3. Siguruesi do ta themelojë komitetin e auditimit, i cili përbëhet nga jo me pak se tre (3) anëtarë, shumica nga të cilët duhet të jenë anëtar joekzekutiv të bordit të drejtorëve të siguruesit dhe një nga anëtarët e komitetit të</p>	<p>3. Decisions of the Board of Directors are valid when there is presence and voting majority of its members.</p> <p>4. Decisions are taken by simple majority of the votes of at least a majority of members present to constitute the quorum, except when the statute required insurers a higher majority for decisions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Committees of the Board of Directors</b></p> <p>1. The Board of Directors should establish an audit committee, risk management committee and investment management committee.</p> <p>2. The insurer may also establish other committees according to its assessment. The CBK within its competence , may require the insurer to establish special committees .</p> <p>3. The insurer shall establish an audit committee, which consists of not less than three (3) members, majority shall be non-executive members of the Board of Directors of the insurer and one of the members of the</p>	<p>CBK-a.</p> <p>3. Odluke Upravnog odbora su važeće kada je prisutna i glasa većina njegovih članova.</p> <p>4. Odluke se donose prostom većinom glasova, najmanje većinom prisutnih članova koji predstavljaju kvorum, osim kada se statutom osiguratelja ne zahteva visoka većina za donošenje odluka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Komisije Upravnog Odbora</b></p> <p>1. Upravni odbor treba da obrazuje revizorsku komisiju, komisiju za upravljanje rizicima i komisiju za upravljanje investiciama.</p> <p>2. Osiguratelj može takođe uspostaviti druge komisije po svojoj proceni. CBK, u okviru svoje nadležnosti, može da zahteva od osiguratelja da uspostavi posebne komisije.</p> <p>3. Osiguratelj će osnovati komisiju za reviziju, koja se sastoji od najmanje tri (3) člana, od kojih su većina članovi ne-izvršnog odbora osiguratelja i jedan od članova komisije za reviziju treba da bude spoljni ekspert, koji</p>
---	--	---



<p>auditimit duhet të jetë ekspert i jashtëm, i cili duhet të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë në fushën e financave, kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p>4. Komiteti i auditimit, ndër të tjera ka edhe këto detyra:</p> <p>4.1. monitoron procesin e raportimit financiar;</p> <p>4.2. monitoron raporte tjera financiare të përcaktuara nga BQK-ja;</p> <p>4.3. i rekomandon siguruesit të mbajë dhe të zbatojë procedura të brendshme për menaxhimin e siguruesit, si dhe shqyrton dhe vlerëson këto procedura;</p> <p>4.4. shqyrton investimet dhe transaksionet, të cilat mund të kenë efekte negative mbi mbarëvajtjen e siguruesit, të sugjeruara nga auditori i brendshëm apo çdo person përgjegjës brenda siguruesit;</p> <p>4.5. propozon udhëheqësin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;</p> <p>4.6. jep rekomandim për emërimin e auditorit të jashtëm dhe monitoron</p>	<p>audit committee should be external expert, who must have not less than 3 years experience in finance, accounting and auditing.</p> <p>4. The Audit Committee, among others, has following tasks:</p> <p>4.1. monitors the financial reporting process;</p> <p>4.2. monitors other financial reports set by the CBK;</p> <p>4.3. recommends insurers to maintain and implement internal procedures for the management of insurer , and reviews and evaluates those procedures;</p> <p>4.4. considers investments and transactions, which may have adverse effects on the operation of the insurer, as suggested by the internal auditor or any person responsible within the insurer;</p> <p>4.5. proposes the head of internal audit unit and monitors the activities of the internal audit unit;</p> <p>4.6. gives recommendation for the appointment of external auditors and</p>	<p>mora imati ne manje od 3 godine iskustva u oblasti finansija, računovodstva i revizije.</p> <p>4. Komisija za reviziju, između ostalog, ima i sledeće zadatke da:</p> <p>4.1. nadgleda proces finansijskog izveštavanja;</p> <p>4.2. nadgleda i druge finansijske izveštaje propisane od strane CBK;</p> <p>4.3. preporučuje osiguratelju da održava i sprovodi interne procedure za upravljanje osiguratelja irazmatrai ocenjuje ove procedure;</p> <p>4.4. razmatra investicije i transakcije što može imati negativne efekte na poslovanje osiguratelja, kao što je predloženo od strane internog revizora ili bilo kog odgovornog lica unutar osiguratelja;</p> <p>4.5. predlaže upravnika jedinice za unutrašnju reviziju i monitoriše aktivnosti jedinice za unutrašnju reviziju;</p> <p>4.6. daje preporuku za imenovanje spoljnog revizora i nadgleda njegovu nezavisnost;</p>
--	--	---

<p>pavarësinë e tij;</p> <p>4.7. shqyrton procedurat për kontrollin e brendshëm.</p> <p>5. Komiteti i auditimit mbledhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga bordi i drejtorëve të siguruesit. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm.</p> <p>6. Komiteti i auditimit i raporton bordit të drejtorëve dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të siguruesit.</p> <p>7. Bordi i drejtorëve të çdo siguruesi do ta themelojë komitetin për menaxhim të rrezikut, i cili përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë nga bordi i drejtorëve. Komiteti për menaxhim të rrezikut ndihmon bordin e drejtorëve në zhvillimin, aprovimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave për menaxhim të rrezikut të siguruesit. Në veçanti, ky komitet duhet:</p> <p>7.1. të rishikojë dhe vlerësojë politikat, strategjitë dhe procedurat e propozuara për menaxhim të rrezikut të siguruesit dhe bën rekomandime për bordin e drejtorëve lidhur me aprovimin e tyre;</p>	<p>monitors its independence;</p> <p>4.7. considers internal control procedures.</p> <p>5. The Audit Committee meets at least four times a year in ordinary and extraordinary meetings whenever called by the Board of Directors of the insurer. Decisions are made by majority vote of all members present.</p> <p>6. The Audit Committee reports to the Board of Directors and helps the latter in the decision making process and oversight of insurer.</p> <p>7. The Board of Directors of each insurer shall establish a risk management committee, which consists of at least three (3) members of the Board of Directors. Risk Management Committee assists the Board of Directors in the development, approval and monitoring of the implementation of risk management policies of insurer. In particular, the committee must:</p> <p>7.1. review and evaluate proposed policies, strategies and procedures for the insurer's risk management and makes recommendations to the Board of Directors for their approval;</p>	<p>4.7. razmatra procedure internu kontrolu.</p> <p>5. Komisija za reviziju se sastaje najmanje četiriuta godišnje na redovnim sastancima i vanrednim sastancima kad god se sazove od Upravnog odbora osiguratelja. Odluke se donosi većinom glasova svih prisutnih članova.</p> <p>6. Komisija za reviziju podnosi izveštaj Upravnom odboru i pomaže mu u procesu odlučivanja i nadzora osiguratelja.</p> <p>7. Upravni odbor svakog osiguratelja osnovaće komisiju za upravljanje rizikom, koja se sastoji od najmanje tri (3) člana Upravnog odbora. Komisija za upravljanje rizicima pomaže Upravni odbor u razvoju, odobravanju i nadgedanju sprovođenja politike upravljanja rizicima osiguratelja. Konkretno, ova komisija treba da:</p> <p>7.1. razmatra i procenjuje politike, strategije i procedure predložene za upravljanje rizikom osiguratelja i daje preporuke Upravnom odboru za njihovo usvajanje;</p>
---	---	--

<p>7.2. të ndihmojë bordin e drejtorëve për të siguruar se programi për menaxhim të rrezikut i siguruesit, zbatohet në përputhje me politikat, strategjitë dhe kufijtë e aprovuar nga bordi i drejtorëve dhe me ligjet, si dhe me rregulloret relevante të BQK-së;</p> <p>7.3. të monitorojë zbatimin e këtyre politikave dhe strategjive, nëpërmjet pranimit të raporteve nga menaxhmenti i lartë dhe njësia për menaxhim të rrezikut, në kuadër të siguruesit;</p> <p>7.4. të rishikojë periodikisht politikat dhe strategjitë për menaxhim të rrezikut të siguruesit dhe t'i rekomandojë bordit të drejtorëve ndonjë ndryshim, që komiteti e konsideron të nevojshme; dhe</p> <p>7.5. të kryejë detyra tjera që i caktohen nga bordi i drejtorëve e që kanë të bëjnë me programin për menaxhim të rrezikut të siguruesit.</p> <p>8. Bordi i drejtorëve i çdo siguruesi do të themelojë komitetin për menaxhim të investimeve, i cili përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë anëtar joekzekutiv i bordit të drejtorëve.</p>	<p>7.2. assist the board of directors to ensure that the risk management program for the insurer is implemented in accordance with the policies, strategies and ceilings approved by the Board of Directors and with the laws and regulations relevant to CBK;</p> <p>7.3. monitor the implementation of those policies and strategies, by receiving reports from senior management and risk management unit within the insurer;</p> <p>7.4. periodically review the policies and strategies for risk management of insurer and recommend to the Board of Directors any changes that the committee deems necessary, and</p> <p>7.5. perform other duties assigned by the Board of Directors for dealing with risk management program for the insurer.</p> <p>8. The Board of Directors of each insurer shall establish investment management committee, which consists of at least three (3) members, of whom , one must be a non-executive member of the Board of Directors .</p>	<p>7.2. pomaže Upravnom odboru da obezbedi da se program upravljanja rizikom za osiguratelja sprovodi u skladu sa politikama, strategijama i granica usvojenih od strane Upravnog odbora i sa relevantnim zakonima i uredbama CBK-a;</p> <p>7.3. nadgleda sprovođenje tih politika i strategija, preko prijema izveštaja iz višeg rukovodstva i jedinice upravljanja rizicima u okviru osiguratelja;</p> <p>7.4. periodično razmatra politiku i strategije za upravljanje rizikom osiguratelja i preporučuje Upravnom odboru sve promene koje komisija smatra potrebnim, i</p> <p>7.5. obavlja i druge poslove koje mu odredi Upravni odbor koje se tiču programa upravljanja rizikom osiguratelja.</p> <p>8. Upravni odbor svakog osiguratelja će osnovati komisiju za upravljanje investicijama, koja se sastoji od najmanje tri (3) člana, od kojih jedan mora biti ne-izvršni član Upravnog odbora.</p>
---	--	---

<p>9. Ky nen nuk zbatohet për siguruesin e jashtëm, për aq sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në, zbatohen me legjislacionin, sipas të cilit siguruesi i jashtëm është licencuar në shtetin amë.</p> <p>10. BQK-ja mund të miratojë rregulla të tjera për mënyrën e funksionimit të komiteteve të bordit të drejtorëve të siguruesit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Menaxhmenti i lartë</b></p> <p>1. Kryeshefi ekzekutiv emërohet nga bordi i drejtorëve të siguruesit.</p> <p>1.1. Kryeshefi ekzekutiv i siguruesit:</p> <p>1.1.1. është përgjegjës për sigurimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së siguruesit dhe zbatimin e strategjisë së përcaktuar të aktivitetit të siguruesit;</p> <p>1.1.2. përfaqëson siguruesin dhe vepron si përfaqësues ligjor i tij;</p> <p>1.1.3. zbaton vendimet e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve;</p>	<p>9. This section does not apply to foreign insurer to the extent that comparable and acceptable requirements to the CBK, are applied in the legislation under which foreign insurer is licensed in their home country.</p> <p>10. The CBK may adopt other rules for the functioning of the committees of the Board of Directors of the insurer.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Senior Management</b></p> <p>1. The Chief Executive Officer is appointed by the Board of Directors of the insurer.</p> <p>1.1. Chief Executive Officer of the insurer:</p> <p>1.1.1. is responsible for ensuring the legality of the activities of insurers and implementation of defined strategy of activities of insurer;</p> <p>1.1.2. represents the insurer and acts as its legal representative;</p> <p>1.1.3. implements the decisions of the General Assembly of Shareholders, the audit committee and Board of Directors;</p>	<p>9. Ovaj član se ne odnosi na stranog osiguratelja u meri do koje uporedivi i prihvatljivi zahtevi za CBK, primenjuju zakonom po kojima je strani osiguratelj licenciran u svojoj matičnoj zemlji.</p> <p>10. CBK može usvojiti druga pravila za funkcionisanje komisija Upravnog odbora osiguratelja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Više rukovodstvo</b></p> <p>1. Izvršni direktor se imenuje od strane Upravnog odbora osiguratelja.</p> <p>1.1. Izvršni direktor osiguratelja je:</p> <p>1.1.1. odgovoran za obezbeđivanje zakonitosti aktivnosti osiguratelja i sprovođenje definisane strategije aktivnosti osiguratelja;</p> <p>1.1.2. predstavlja osiguratelja i deluje kao njegov pravnizastupnik;</p> <p>1.1.3. sprovodi odluke Generalne Skupštine akcionara, komisije za reviziju i Upravnog odbora;</p>
---	---	---

<p>1.1.4. organizon dhe menaxhon veprimtaritë e përditshme të siguruesit;</p> <p>1.1.5. merr vendime për të gjitha çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, komitetit të auditimit dhe bordit të drejtorëve të siguruesit; dhe</p> <p>1.1.6. kryen funksione tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e siguruesit.</p> <p>2. Zëvendëskryeshefi ekzekutiv zëvendëson kryeshefin ekzekutiv në mungesë të tij dhe nëse siguruesi nuk ka zëvendëskryeshef të emëruar, atëherë kryeshefi ekzekutiv autorizon me shkrim njërin nga menaxherët e lartë, që ta zëvendësojë atë dhe t'i ushtrojë kompetencat e tij, përkohësisht.</p> <p>3. Të gjithë menaxherët e lartë i raportojnë bordit të drejtorëve për çdo interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me individët e ndërlidhur apo me ndonjë person juridik, me të cilin siguruesi ka hyrë ose ka ndërmend të hyjë në marrëdhënie afariste.</p>	<p>1.1.4. organizes and manages the daily operations of the insurer;</p> <p>1.1.5. takes decisions on all matters that are not within the competence of the General Assembly of Shareholders, the audit committee and Board of Directors of the insurer, and</p> <p>1.1.6. performs other functions, in accordance with applicable laws and statutes of the insurer.</p> <p>2. Deputy Chief Executive replaces CEO in his absence and if the insurer has not appointed Deputy CEO, then Chief Executive Officer authorizes in writing, one of the top managers to replace him and to exercise his powers, temporarily.</p> <p>3. All senior managers reporting to the Board of Directors on any interest, directly or indirectly related to individuals with any person or entity with whom the insurer has entered or intends to enter into a business relationship</p>	<p>1.1.4. organizuje i rukovodi dnevnim aktivnostima osiguratelja;</p> <p>1.1.5. donosi odluke o svim pitanjima koja nisu u nadležnosti Generalne Skupštine akcionara, komisije za reviziju i Upravnog odbora osiguratelja; i</p> <p>1.1.6. vrši i druge funkcije u skladu sa važećim zakonodavstvom i statusom osiguratelja.</p> <p>2. Zamenik izvršnog direktora ga zamenjuje u slučaju njegove odsutnosti, u slučaju da osiguratelj nije imenovao Zamenika izvršnog direktora, izvršni direktor ovlašćuje pismeno jednog od viših rukovodilaca da ga zameni i da vrši njegova ovlašćenja, privremeno.</p> <p>3. Svi viši rukovodioci izveštavanju Upravnom odbora za bilo koji direktan ili indirektan interes sa relevantnim pojedincima ili nekom pravnom osobom sa kojim je osiguratelj stupio ili namerava da stupi u poslovni odnos.</p>
--	--	--

<p align="center"><b>Neni 32</b> <b>Kualifikimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë</b></p>	<p align="center"><b>Article 32</b> <b>Qualification of Directors and Senior Managers</b></p>	<p align="center"><b>Član 32</b> <b>Kvalifikacije direktora i viših upravnika</b></p>
<p>1. Čdo drejtor dhe menaxher i lartë i siguruesit duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm me reputacion të mirë, i cili duhet t'i plotësojë kriteret e përcaktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin.</p> <p>2. Përveç siç është përcaktuar në nenin 24 të këtij Ligji, personi nuk konsiderohet i përshtatshëm nëse i njëjti:</p> <p>2.1. është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me 6 muaj apo më shumë burg.</p> <p>2.2. është larguar nga posti i një siguruesi me kërkesë të BQK-së;</p> <p>2.3. me vendim të organeve kompetente i është hequr ose pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit;</p> <p>2.4. ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një siguruesi, licenca e të cilit është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruar i atij siguruesi është iniciuar gjatë mandatit të tij.</p>	<p>1. Each director and senior manager of the insurer should be capable and appropriate with good reputation , who must meet the criteria set by the CBK regarding qualifications , experience and integrity.</p> <p>2. Except as provided in Article 24 of this Law, a person shall not be eligible if the one:</p> <p>2.1. is sentenced by a final court decision for a criminal offense, with 6 or more months sentenced;</p> <p>2.2. is removed from office of a provider upon the request of the CBK;</p> <p>2.3. upon a decision of the competent authorities, the right to exercise the profession has been suspended and removed;</p> <p>2.4. has been a director or senior manager of an insurer whose license is revoked, or failure of payment or forced liquidation of the insurer was initiated during his term.</p>	<p>1. Svaki direktor i viši rukovodilac osigurateljatreba biti spreman i u skladu sa dobrom reputacijom, koji moraju da ispunjavaju kriterijume postavljene od strane CBK u pogledu kvalifikacija, iskustva i integriteta.</p> <p>2. Osim kako je predviđeno u članu 24. ovog zakona, lice neće biti odgovarajuće, ukoliko je isto:</p> <p>2.1. osuđeno pravosnažnom sudskom presudom za krivično delo, sa kaznom zatvora od najmanje 6 meseci ili više;</p> <p>2.2. udaljeno sa dužnosti osiguratelja na zahtev CBK-a;</p> <p>2.3. odlukom nadležnih organa mu je ukinuto ili suspendovano pravo na izvršavanje profesije;</p> <p>2.4. bilo direktor ili viši upravnik jednog osiguratelja, kome je oduzeta licenca ili zbog neuspeha u naplati ili prinudnoj likvidaciji onog osiguratelja koji je licenciran tokom njegovog mandata.</p>

<p>3. Një person konsiderohet i kualifikuar, nëse ai person është i diplomuar në nivel universitar dhe ka përvojë të duhur, sipërcakton BQK-ja me rregullore.</p> <p>4. Një person nuk mund të emërohet apo të zgjidhet si drejtor ose menaxher i lartë i siguruesit, nëse ai person ka shërbyer gjatë gjashtë (6) muajve të mëparshëm në BQK.</p> <p>5. Siguruesit, sapo të vihet në dijeni të rrethanave të cilat tregojnë se ndonjë drejtor ose menaxher i lartë mund të mos jetë person i përshtatshëm dhe i duhur, duhet ta njoftojë menjëherë BQK-në.</p>	<p>3. A person is considered qualified if that person have university degree and has adequate experience, as required by CBK regulation.</p> <p>4. A person cannot be appointed or elected as a director or senior manager of the insurer, if that person has served during six (6) previous months in the CBK.</p> <p>5. Once being aware of circumstances which indicate that any director or senior manager may not be the appropriate and right person, insurers should immediately notify the CBK.</p>	<p>3. Lice se smatra kvalifikovanim, ukoliko je to lice ima odgovarajuće iskustvo, kao što je određeno uredbom CBK-a.</p> <p>4. Lice ne može biti imenovano ili izabrano kao direktor ili rukovodilac osiguratelja, ako je to lice je vršilo službu šest (6) meseci ranije u CBK.</p> <p>5. Osiguratelj, čim postanu svesni okolnosti koje govore da neki direktor ili viši upravnik ne može biti odgovarajuće i potrebno lice, treba odmah da obaveste CBK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë</b></p> <p>1. Asnjë person nuk mund të ushtrojë funksionin e anëtarit të bordit të drejtorëve apo si menaxher i lartë te një sigurues, nëse paraprakisht nuk është marrë aprovimi me shkrim nga BQK-ja.</p> <p>2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet për degën e siguruesit të jashtëm vetëm në lidhje me menaxherët e lartë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Appointment of Directors and Senior Managers</b></p> <p>1. No person can perform the function of a member of the Board of Directors or senior manager of an insurer, if t has not previously received written approval from the CBK.</p> <p>2. Paragraph 1 of this article applies to branches of foreign insurer only about senior managers.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Imenovanje direktora i viših upravnika</b></p> <p>1. Nijedna osoba ne može da obavlja funkciju člana odbora direktora ili višeg upravnika osiguratelja, ako prethodno nije dobijeno pismeno odobrenje od CBK.</p> <p>2. Stav 1. ovog člana sprovodi se i za filijalu spoljašnjeg osiguratelja samo u odnosu na više upravnike.</p>

<p align="center"><b>Neni 34</b></p> <p align="center"><b>Konflikti i interesit dhe transaksionet me palë të ndërlidhura</b></p>	<p align="center"><b>Article 34</b></p> <p align="center"><b>Conflicts of Interest and Related Party Transactions</b></p>	<p align="center"><b>Član 34</b></p> <p align="center"><b>Sukob interesa i transakcije sa povezanim strankama</b></p>
<p>1. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të shmangin interesin privat, i cili krijon konflikt me interesin e siguruesit.</p> <p>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, drejtorët e informojnë paraprakisht asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, ndërsa menaxherët e lartë e informojnë bordin e drejtorëve, nëse ata kanë interesa private të tilla, që ndikojnë gjykimin e tyre për transaksione apo çështje të caktuara, duke krijuar konflikt interesi. Interesat private janë ato interesa që bazohen ose burojnë nga:</p> <p>2.1. marrëdhënie pasurore e drejtpërdrejte ose e tërthortë të çdo lloj natyre;</p> <p>2.2. çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;</p> <p>2.3. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;</p> <p>2.4. angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura;</p> <p>2.5. marrëdhënie me palë të ndërlidhura.</p>	<p>1. Directors and senior managers should avoid private interests which conflict with the interests of the insurer.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this article, the directors previously inform the General Assembly of shareholders, senior managers inform the Board of Directors, if they have such private interests which affect their judgment for certain transactions or issues, creating a conflict of interest. Private interests are those interests that are based on or derived from:</p> <p>2.1. the relationship of the property directly or indirectly of any nature;</p> <p>2.2. any other civil and legal relations;</p> <p>2.3. gifts, promises, favors, preferential treatment;</p> <p>2.4. commitments in private activities for profit or any other activities which generate income;</p> <p>2.5. relationships with related parties.</p>	<p>1. Direktori i viši upravnci treba da izbegavaju privatne interese koji su u sukobu sa interesima osiguratelja.</p> <p>2. Nezavisno od stava 1. ovog člana, direktori prethodno obaveštavaju Skupštinu akcionara, dok viši upravnci obaveštavaju Upravni odbor, ukoliko imaju takve privatne interese koji utiču na njihov sud o određenim transakcijama ili pitanjima, koja stvaraju sukob interesa. Privatni interesi su ti interesi koji se zasnivaju na ili su izvedeni iz:</p> <p>2.1. direktnog ili indirektnog imovinskog odnosa bilo koje prirode;</p> <p>2.2. bilo kog drugog pravnog-civilnog odnosa;</p> <p>2.3. poklona, obećanja, usluga, povlašćenog pristupa;</p> <p>2.4. angažovanje u ostalim privatnim delatnostima u cilju profita ili bilo koje aktivnosti koje stvaraju prihode;</p> <p>2.5. odnosa sa povezanim strankama.</p>



<p>3. Deklarimi i interesave private sipas përcaktimeve të paragrafit 2. të këtij neni, i njoftohen me shkrim asamblesë së përgjithshme dhe bordit të drejtorëve herë pas here, por jo më rrallë se një herë në vit.</p>	<p>3. The declaration of private interests as defined in paragraph 2 of this section shall be notified in writing to the General Assembly and the Board of Directors from time to time, but not less frequently than once a year.</p>	<p>3. Izjava o privatnim interesima, kao što je definisano u stavu 2. ovog Člana, dostavlja se u pisanoj formi Generalnoj skupštini i Upravnom odboru, s vremena na vreme, ali ne ređe od jednom godišnje.</p>
<p>4. Marrëdhëniet dhe transaksionet biznesore me palë të ndërlidhura, në të cilat anëtari i bordit të drejtorëve ka interes, duhet të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut.</p>	<p>4. Business relationships and transactions with related parties, in which a member of the Board of Directors has an interest, shall be performed in accordance with normal market conditions.</p>	<p>4. Poslovni odnosi i transakcije sa povezanim licima, u kojima član Upravnog odbora ima interes, vrše se u skladu sa normalnim tržišnim uslovima.</p>
<p>5. Siguruesi duhet të hartojë procedura për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të cilat duhet të përfshijnë informimin për konfliktin e mundshëm të interesit, kërkesa të veçanta për transaksionet që duhet të kryhen në përputhje me kushtet normale të tregut, si dhe kur gjykohet e përshtatshme, marrja e miratimit paraprak të bordit të drejtorëve apo të asamblese së përgjithshme të aksionareve për kryerjen e këtyre transaksioneve.</p>	<p>5. The insurer must establish procedures for dealing with conflicts of interest, which should include information on the potential conflict of interest, special requirements for transactions to be carried out in accordance with normal market conditions, as and when deemed appropriate, obtaining the prior approval of the Board of Directors or the General Assembly of Shareholders for the performance of those transactions.</p>	<p>5. Osiguratelj mora da uspostavi procedure za slučajeve sukoba interesa, koji bi trebalo da sadrže informacije o potencijalnom sukobu interesa, posebnim zahtevima za transakcije koje treba da se obave u skladu sa normalnim tržišnim uslovima, kao i kada se smatraju potrebnim, uz prethodno odobrenje Upravnog odbora ili Skupštine akcionara za obavljanje ovih transakcija.</p>
<p>6. Bordi i drejtorëve mund të ngrrejë dhe të autorizojë komitete të posaçme, të cilët ngarkohen me përgjegjësinë për trajtimin e konfliktit të interesit.</p>	<p>6. The Board of Directors may authorize and establish special committees, which are charged with the responsibility of handling conflicts of interest.</p>	<p>6. Upravni odbor može ovlastiti i uspostaviti posebne odbore, koji se zadužuju odgovornošću za tretiranje sukoba interesa.</p>
<p>7. Siguruesi krijon një sistem të përshtatshëm kontrolli të brendshëm, për transaksionet me</p>	<p>7. The insurer creates an appropriate system of internal control, for transactions with persons</p>	<p>7. Osiguratelj stvara odgovarajući sistem interne kontrole za transakcije sa licima ili sa</p>

<p>persona ose palë të ndërlidhura, ku përfshihet monitorimi i kontratave, marrëveshjeve afatgjata apo marreveshje të një rëndësie të veçantë për siguruesin për sa i përket konfliktit të interesit.</p> <p>8. Në rastin e mosdeklarimit të konfliktit të interesit, sipas këtij neni ose kur kontrata apo veprimi juridik është lidhur në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit, merren masat e mëposhtme:</p> <p>8.1. Bordi i drejtorëve dhe çdo aksionar i siguruesit, ka të drejtë t'i kërkojë Gjykatës deklarimin e pavlefshmërisë së kontratës ose të veprimit tjetër juridik;</p> <p>8.2. BQK-ja ka të drejtë t'i kërkojë siguruesit shkarkimin e personit në fjalë.</p> <p>9. Dispozitat e këtij neni për siguruesin e jashtëm, zbatohet vetëm për menaxherët e lartë të tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Kërkesat për aksionarët kryesorë</b></p> <p>1. Zotërimi i aksioneve në një sigurues, ku një aksionar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi arrin ose tejkalon nivelin e të qenit aksionar kryesor, bëhet vetëm me miratim paraprak të BQK-së pas paraqitjes së kërkesës për të qenë aksionar</p>	<p>or related parties, including the monitoring of contracts, agreements or arrangements of a long-term importance to the insurer in terms of conflict of interest.</p> <p>8. In case of non-declaration of conflict of interest, in accordance with this article, or when the contract or legal action is related to the conditions of existence of conflict of interest, the following measures will be taken:</p> <p>8.1. The Board of Directors and any shareholder of the insurer have the right to ask the court to declare the contract invalid or other legal action;</p> <p>8.2. The CBK has the right to require from the insurer the dismissal of the proper person.</p> <p>9. The provisions of this article for foreign insurer are applied only to its top managers.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Principal Shareholders Requirements</b></p> <p>1. The ownership of shares in an insurer, where a shareholder directly or indirectly reaches or exceeds the level of being a major shareholder, will be made only with the prior approval of the CBK after applying to be a</p>	<p>povezanim licima, uključujući i praćenje ugovora, dugoročnih sporazuma ili aranžmana od dugoročnog značaja za osiguratelja u pogledu sukoba interesa.</p> <p>8. U slučaju neprijavlivanja sukoba interesa, u skladu sa ovim članom, ili kada je ugovor ili pravni postupak u vezi sa uslovima postojanja sukoba interesa, preduzimaju se sledeće mere:</p> <p>8.1. Upravni odbor i svaki akcionar osigurateljaima pravo da zatraži od suda da poništi ugovor ili drugu pravnu delatnost;</p> <p>8.2. CBK ima pravo da zahteva od osiguratelja razrešenje lica o kojem je reč.</p> <p>9. Odredbe ovog člana za spoljašnjeg osiguratelja, sprovode se samo za njegove više upravnike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Zahtevi za glavne akcionare</b></p> <p>1. Posedovanje akcija u osiguratelju, gde jedan akcionar, direktno ili indirektno dostiže ili prelazi nivo glavnog akcionara, postiže se samo uz prethodno odobrenje CBK nakon dostavljanja zahteva za postajanje glavnog</p>
---	---	--

<p>kryesor.</p> <p>2. BQK-ja, përveç siç është parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni, miraton çdo zotërim të mëtejme të aksioneve që janë të barabarta ose tejkalojnë 10%, 20%, 30% dhe 50% të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e siguruesit.</p> <p>3. Aksionari, i cili ka marrë miratimin e parashikuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, njofton paraprakisht BQK-në nëse ai kërkon zvogëlimin e pjesëmarrjes së tij në aksione.</p> <p>4. BQK-ja mund të përcaktojë rregulla mbi aksionarët kryesorë me prejardhje nga vendet tjera, si dhe mbi bashkëpunimin e BQK-së me autoritetet mbikëqyrëse të këtyre vendeve.</p> <p>5. BQK-ja mund t'i miratojë aksionarët kryesorë, nëse plotësohen kërkesat e parashikuara në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe refuzon aprovimin për aksionarët kryesorë nëse gjykon se:</p> <p>5.1. veprimet e kryera në të kaluarën nga aksionari kryesor apo personat/palët e ndërlidhura me të mund të përkeqësojnë veprimtarinë e siguruesit në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut apo mund të vështirësojnë ose bëjnë të pamundur</p>	<p>major shareholder.</p> <p>2. Except as provided in paragraph 1 of this section, the CBK shall adopt any further ownership of shares equal or exceeding 10 %, 20 %, 30 % and 50 % of the voting rights or participation in the capital of insurers.</p> <p>3. A shareholder who has received approval provided for in paragraphs 1 and 2 of this section will inform the CBK if it requires reducing its participation in stocks.</p> <p>4. The CBK may outline the rules on the main shareholders originating from other countries, as well as on cooperation of the CBK with supervisory authorities of those countries.</p> <p>5. The CBK may approve principal shareholders, if the requirements laid down in accordance with the provisions of this law are met and may refuse approval of main shareholders, if it determines that:</p> <p>5.1. actions performed, in the past, by the main shareholder or persons/related parties could aggravate actions related to the rules of risk management, or could hinder or make impossible the exercise of oversight by the CBK;</p>	<p>akcionara.</p> <p>2. CBK, izuzev kao što je predviđeno u stavu 1. ovog člana, usvaja bilo kakvo dalje posedovanje akcija jednakih ili većih od 10%, 20%, 30% i 50% prava glasa ili učešća u kapitalu osiguratelja.</p> <p>3. Akcionar koji je dobio odobrenje predviđeno u stavovima 1. i 2. ovog člana, informiše CBK, ukoliko on zahteva smanjenje svog učešća u akcijama.</p> <p>4. CBK može da odredi propise o glavnim akcionarima sa poreklom iz drugih zemalja mesta i o saradnji CBK sa nadzornim organima tih zemalja.</p> <p>5. CBK može da odobri glavne akcionare, ako su ispunjeni uslovi propisani u skladu sa odredbama ovog zakona i može da odbije saglasnost za glavne akcionare, ako utvrdi da:</p> <p>5.1. radnje koje su izvršene u prošlosti od strane glavno akcionara ili osobe/povezane stranke sa njim mogu pogoršati delatnost osiguratelja u vezi sa pravilima upravljanja rizikom, ili mogu ometati ili učiniti nemogućim ostvarivanje nadzora od strane</p>
--	--	--

<p>ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja;</p> <p>5.2. në rastin e kërkesës nga aksionarët kryesorë të jashtëm, zbatimi i legjislacionit apo praktikave të legjislacionit të vendit të tij, vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja.</p> <p>6. BQK-ja, nëse gjykon se një person, i cili është aksionar kryesor në një sigurues vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji dhe me rregullat për menaxhimin e kujdesshëm e të përshtatshëm të siguruesit, merr masat e duhura për përfundimin e kësaj situatë.</p> <p><b>KAPITULLI V</b> <b>TRANSFERIMI I PORTOFOLIT DHE DELEGIMI I FUNKSIONEVE</b></p> <p><b>Neni 36</b> <b>Transferimi i portofolit të sigurimit</b></p> <p>1. Siguruesi me miratim të BQK-së, mund të transferojë nëpërmjet një marrëveshje te një sigurues tjetër, të gjitha ose një pjesë të portofolit të saj të sigurimit, të nënshkuara në një apo disa klasa të caktuara të sigurimit me të gjitha detyrimet dhe të drejtat. Për qëllime të këtij Ligji, siguruesi i cili i transferon portofolin e sigurimit, quhet sigurues transferues, kurse siguruesi tek i cili transferohen kontratat e</p>	<p>5.2. in the case of request from key external stakeholders, implementation of legislation or legislative practices of its country, making it difficult or impossible to exercise oversight of the CBK.</p> <p>3. If the CBK evaluates that a person who is a major shareholder in an insurer, acts contrary to the provisions of this law and the rules for careful and appropriate management of the insurer, it can take appropriate measures for the completion of this situation.</p> <p><b>CHAPTER V</b> <b>THE PORTFOLIO ASSIGNMENT AND DELEGATION OF FUNCTIONS</b></p> <p><b>Article 36</b> <b>Transfer of Insurance Portfolio</b></p> <p>1. The insurer may, with the approval of the Central Bank, transfer through an agreement to another insurer, all or part of its insurance portfolio, signed in one or several specific classes of insurance with all the obligations and rights. For the purposes of this Law, the insurer which transfers insurance portfolio will be called the transferring insurer, and the insurer to whom insurance contracts are</p>	<p>CBK;</p> <p>5.2. u slučaju zahteva od ključnih spoljnih akcionara, sprovođenje zakonodavstva ili zakonskih praksi svoje zemlje, otežavaju ili čine nemogućim vršenje nadzora od CBK.</p> <p>6. CBK, ako utvrdi da osoba koja je glavni akcionar u jednom osiguratelju postupa suprotno odredbama ovog Zakona i pravila za pažljivo i odgovarajuće upravljanje osigurateljem, preduzima neophodne mere za okončanje ove situacije.</p> <p><b>POGLAVLJE V</b> <b>PRENOŠENJE PORTFELJA I DELEGIRANJE FUNKCIJA</b></p> <p><b>Član 36</b> <b>Prenos portfelja osiguranja</b></p> <p>1. Osiguratelj uz odobrenje CBK, može preneti putem dogovora do drugog osiguratelja, sve ili deo svojih portfelja o osiguranju, koji su potpisani u jednoj ili više specifičnih vrsta osiguranja sa svim obavezama i pravima. Za potrebe ovog zakona, osiguratelj koji prenosi portfelje o osiguranju osiguratelja, zove se osiguratelj prenosilac ugovora, dok onaj na koji se prenose ugovori o osiguranju, zove se</p>
--	---	---

<p>sigurimit, quhet sigurues pranues.</p> <p>2. Siguruesi përveç siç është parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni, transferon edhe aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, të barabarta me provizionet teknike dhe matematike të përlllogaritura, për të mbuluar përgjegjësitë e portofolit të sigurimit që do të transferohen.</p> <p>3. Portofoli i sigurimit mund të transferohet te siguruesi pranues, pasi kjo e fundit ka marrë miratimin e BQK-së për të pranuar portofolin e sigurimeve.</p> <p>4. Për transferimin e portofolit të sigurimit nuk kërkohet miratimi i të siguruarve.</p> <p>5. Siguruesi pranues njofton të siguruarit për transferimin e portofolit të sigurimit, me anë të mjeteve publike të komunikimit, në territorin ku ndodhet rreziku i mbuluar nga kontratat e sigurimit të transferuara, brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga data e miratimit të BQK-së për transferim të portofolit.</p> <p>6. Siguruesi mund të transferojë portofolin e saj të sigurimit te:</p> <p>6.1. siguruesi me seli qendrore në</p>	<p>transferred, the insurer is called the receiving insurer.</p> <p>2. Except as provided in paragraph 1 of this section, the insurer transfers the assets covering technical and mathematical provisions, equal with calculated technical and mathematical provisions, to cover the liabilities of the insurance portfolio to be transferred.</p> <p>3. The portfolio insurance can be transferred to the receiving insurer, after it has received the approval of the CBK to accept insurance portfolio.</p> <p>4. For transfer of insurance portfolio the approval of the insured is not required.</p> <p>5. The insurer receiver shall notify the insured about receiving the transfer of the insurance portfolio, by means of public communication in the territory, where is the risk covered by transferred insurance contracts, within ten (10) calendar days from the date CBK approval of the transfer of the portfolio.</p> <p>6. The insurer may transfer its portfolio of insurance:</p> <p>6.1. to an insurer with headquarters in the</p>	<p>osiguratelj primatelj.</p> <p>2. Osiguratelj, osim kako je predviđeno u stavu 1. ovog člana, vrši prenos sredstava/aktiva za pokriće tehničkih i matematičkih provizija, jednakih sa tehničkim i matematičkim provizijama obračunatim za pokrivanje obaveza portfelja osiguranja koje će se preneti.</p> <p>3. Portfelj osiguranja može se preneti na osiguratelja primatelja, nakon što je ovaj posljednji dobio odobrenje CBK za prihvatanje portfelja osiguranja.</p> <p>4. Za transfer portfelja o osiguranju ne zahteva se saglasnost osiguranika.</p> <p>5. Osiguratelj primatelj je dužan da obavesti osiguranike o prenosu portfelja osiguranja, putem javnih sredstava komunikacije, na delu gde je rizik pokriven prenesenim ugovorima o osiguranju, u roku od deset (10) kalendariskih dana od dana odobrenja CBK-a za prenošenje portfelja.</p> <p>6. Osiguratelj može da prenese svoj portfelja osiguranja na:</p> <p>6.1. osiguratelj sa sedištem u Republici</p>
---	--	--

<p>Republikën e Kosovës, i licencuar nga BQK-ja;</p> <p>6.2. dega e një siguruesi të jashtëm, e licencuar nga BQK-ja.</p> <p>7. Siguruesi transferues paraqet në BQK, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e transferimit të portofolit, një dokument që vërteton se transferimi është finalizuar.</p> <p>8. Nëse tranferimi i portofolit nuk është realizuar sipas marrëveshjes, BQK-ja mund ta tërheqë miratimin.</p>	<p>Republic of Kosovo, licensed by the CBK;</p> <p>6.2. to branch of a foreign insurer licensed by the CBK.</p> <p>7. The transferring insurer submits to the CBK, within 15 calendar days from the portfolio transfer day, a documents proving that the transfer is done.</p> <p>8. If the portfolio transfer is not done under agreement, the CBK may withdraw the approval.</p>	<p>Kosovo licenciranog od CBK;</p> <p>6.2. filijalu stranog osiguratelja licenciranog od CBK.</p> <p>7. Osiguratelj prenosilac prenosi svoj portfelj osiguranja na osiguranje osiguratelja primatelja, u roku od petnaest (15) dana od dana dobijanja odobrenja od strane CBK.</p> <p>8. Ukoliko prenos portfelja nije realizovan prema sporazumu, CBK može da opozove odobrenje.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit</b></p> <p>1. Kërkesa për transferimin e portofolit të sigurimit bëhet me shkrim nga siguruesi transferues dhe përmban:</p> <p>1.1. miratimin e transferimit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordit të drejtorëve të siguruesit transferues;</p> <p>1.2. miratimin e transferimit të siguruesit pranues nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe bordi i drejtorëve të tij;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Request for Transfer of Insurance Portfolio</b></p> <p>1. The request for transfer of the insurance portfolio is made in writing by the transferring insurer and contains:</p> <p>1.1. approval of the transfer by the General Assembly of Shareholders and Board of Directors of the insurers transfer;</p> <p>1.2. approval of the transfer of the receiving insurer by the General Assembly of Shareholders and its Board of Directors;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Zahtev za prenos portfelja osiguranja</b></p> <p>1. Zahtev za prenos portfelja osiguranja vrši se u pisanoj formi od strane osiguratelja prenosioca i sadrži:</p> <p>1.1. odobravanje transfera od strane Skupštine akcionara i Upravnog odbora osiguratelja prenosioca;</p> <p>1.2. odobravanje prenosa na osiguratelja primatelja od Skupštine akcionara i Upravnog odbora;</p>

<p>1.3. listën e kontratave të sigurimit, të ndara sipas klasave të sigurimit, së bashku me kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të tyre, që kërkohen të transferohen si dhe llogaritjet e provizioneve teknike dhe matematike për klasat e sigurimit në fjalë;</p> <p>1.4. aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, përfshirë këtu vlerën e tyre përkatëse, si dhe të gjitha të dhënat që mund të përdoren për verifikimin e llogaritjes së këtyre vlerave;</p> <p>1.5. planin e ndryshuar të biznesit që nevojitet për transferimin e portofolit të sigurimit, të siguruesit pranues;</p> <p>1.6. kontratën e transferimit të portofolit të sigurimit.</p> <p>1.7. afatin kohor për transferimin e portofolit</p>	<p>1.3. list of insurance contracts, divided by classes of insurance, along with their special and general conditions required, as well as technical and mathematical calculations required for insurance classes in question;</p> <p>1.4. Assets covering technical and mathematical provisions, including their respective value, and all data that can be used to verify the calculation of those values;</p> <p>1.5. Changed business plan which is needed to transfer the insurance portfolio, the receiving insurer;</p> <p>1.6. The contract of insurance portfolio transfer.</p> <p>1.7. the timeline for portfolio transfer</p>	<p>1.3. spisak ugovora o osiguranju, podeljenih po vrstama osiguranja, zajedno sa njihovim uopštenim i posebnim uslovima, potrebnim za prenos, kao i proračune tehničkih i matematičkih provizija za vrste dotičnih osiguranja;</p> <p>1.4. sredstva/aktive u pokrivanju tehničkih i matematičkih provizija, uključujući i njihovu datu vrednosti, kao i sve podatke koji se mogu koristiti za proveru obračuna tih vrednosti;</p> <p>1.5. izmenjeni plan poslovanja koji je potreban za prenos portfolia osiguranja, na osiguratelja primatelja;</p> <p>1.6. ugovor o prenosu portfelja osiguranja;</p> <p>1.7. vremenski rok za prenošenje portfelja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Miratimi dhe refuzimi i kërkesës për transferimin e portofolit të sigurimit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Approval and Denial of the Request for Transfer of Insurance Portfolio</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Odobrenje i odbijanje zahteva za prenos portfelja osiguranja</b></p>
<p>1. BQK-ja brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e pranimit të kërkesave të plotësuara sipas parashikimeve të neneve 36 dhe 37 të këtij Ligji, miraton ose refuzon transferimin e portofolit të sigurimit.</p>	<p>1. The CBK will approve or deny the transfer of the insurance portfolio within thirty (30) calendar days from the date of receipt of completed applications under the provisions of Articles 36 and 37 of this Law.</p>	<p>1. CBK, u roku od trideset (30) kalendarskih dana od dana prijema potpunjenih prijava po odredbama člana 36 i 37 ovog zakona, odobrava ili odbija prenos portfelja osiguranja.</p>

<p>2. Në rastin kur siguruesi pranues është degë e një siguruesi të jashtëm, BQK-ja merr vendim për miratim, vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës i vendit amë, jep miratimin me shkrim.</p> <p>3. BQK-ja refuzon kërkesën për transferimin e portofolit të sigurimit nëse:</p> <p>3.1. siguruesi pranues nuk është i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit të sigurimit që transferohet;</p> <p>3.2. vlera e aktiveve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike të siguruesit pranues është më e ulët sesa vlera e provizioneve, që duhet të krijoheshin kundrejt portofolit të sigurimit, që do të transferohet.</p> <p>3.3. siguruesi pranues nuk plotëson kërkesat ligjore për klasat e sigurimeve, që i përkasin portofolit që transferohet ose në qoftë se me pranimin e portofolit veprimtaria e siguruesit pranues në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut mund të përkeqësohet.</p> <p>4. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore, përmes së cilës përcakton kërkesa shtesë, në lidhje me transferimin e portofolit të sigurimit.</p>	<p>2. In case when the receiving insurer is a branch of foreign insurer, the CBK decides for approval only if the home country supervisory authority gives a written approval.</p> <p>3. The CBK rejects the request for the transfer of the insurance portfolio if:</p> <p>3.1. the receiving insurer is not licensed to practice in the insurance classes belonging to the insurance portfolio to be transferred;</p> <p>3.2. the value of assets covering technical and mathematical provisions of the receiving insurer is lower than the value of provisions that should be created against the insurance portfolio, which will be transferred.</p> <p>3.3. the insurer does not meet the entrance requirements for insurance classes belonging to portfolio to be transferred or if by the acceptance of portfolio the activity of the receiving insurer with respect to the rules of risk management may worsen.</p> <p>4. The CBK may issue regulations by which establishes additional requirements in connection with the transfer of the insurance</p>	<p>2. U slučaju kada je osiguratelj primatelj filijala stranog osiguratelja, CBK odlučuje za odobrenje, osim ako Nadzorni organ matične zemlje daje pismenu saglasnost.</p> <p>3. CBK odbija zahtev za prenos portfelja osiguranja, ako:</p> <p>3.1. osiguratelj primatelj nije licenciran da obavlja delatnost u obavljanju vrsta osiguranja koja pripadaju portfelju osiguranja koje se prenosi;</p> <p>3.2. vrednost sredstava/aktiva za pokriće tehničkih i matematičkih provizija osiguratelja primatelja je niža od vrednosti provizija koje je potrebno napraviti u odnosu na portfelje osiguranja, koji će biti prenesen.</p> <p>3.3. osiguratelj primatelj ne ispunjava zakonske uslove za vrste osiguranja koje pripadaju portfelju koji se prenosi, ili ako prihvatanjem portfelja, aktivnosti osiguratelja primatelja u vezi sa pravilima upravljanja rizikom mogu biti pogoršana.</p> <p>4. CBK može da donese jednu uredbu, preko koje se određuju dodatni zahtevi, u vezi transfera portfelja osiguranja.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Miratimi i delegimit të funksioneve</b></p> <p>1. Siguruesi mund të delegojë funksionet, pasi të ketë marrë miratimin paraprak me shkrim të BQK-së.</p> <p>2. Funksionet e siguruesit mund të delegohen, vetëm nëpërmjet një kontrate të shkruar, në bazë të cilës siguruesi transferon një pjesë të funksioneve të saj, te një person tjetër.</p> <p>3. Kontrata për delegimin e funksioneve duhet të përmbajë një dispozitë, e cila përcakton se siguruesi që delegon përgjegjësinë është përgjegjëse për funksionet e transferuara te personi tjetër. Kontrata për delegimin e funksioneve, po ashtu duhet të përcaktojë se personi pranues i funksioneve të deleguara, do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.</p> <p>4. BQK-ja mund të refuzojë apo tërheq miratimin e delegimit të funksioneve nëse:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. rrezikohen interesat e të siguruarve;</p> <p style="padding-left: 20px;">4.2. vështirësohet ose bëhet e pamundur mbikëqyrja në lidhje me funksionet e deleguara;</p>	<p>portfolio.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Approval of Delegating Functions</b></p> <p>1. The insurer may delegate functions, after obtaining the prior written approval of the CBK.</p> <p>2. The insurer's functions may be delegated only by a written contract under which the insurer transfers a part of its functions to another person.</p> <p>3. The contract for the delegation of functions must contain a clause stipulating that the insurer delegating the responsibility is responsible for the functions transferred to another person. The contract for the delegation of functions should also determine that the person receiving the delegated functions will be subject to supervision by the CBK.</p> <p>4. The CBK may refuse or withdraw approval of delegation of functions if:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. the interests of the insured are at risk;</p> <p style="padding-left: 20px;">4.2. becomes difficult or impossible for the supervision in connection with the delegated functions;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Odobrovanje i delegiranje funkcija</b></p> <p>1. Osiguratelj može da prenese funkcije, nakon prethodno dobijenog pismenog odobrenja od strane CBK.</p> <p>2. Funkcije osiguratelja se mogu delegovati samo putem pismenog ugovora pod kojim osiguratelj prenosi deo svojih funkcija na drugo lice.</p> <p>3. Ugovor za delegiranje funkcija mora da sadrži odredbu po kojoj je osiguratelj koji deleguje odgovornost, odgovoran za funkcije prenesene na drugo lice. Ugovor za delegiranje funkcija, bi trebalo takođe da utvrdi da će osoba koja je primatelj delegiranih funkcija biti pod nadzorom CBK.</p> <p>4. CBK može da odbije ili povuče saglasnost o delegiranju funkcija ako:</p> <p style="padding-left: 20px;">4.1. se rizikuju interesi osiguranika;</p> <p style="padding-left: 20px;">4.2. postaje težak ili nemoguć nadzor u vezi sa delegiranim funkcijama;</p>
---	---	---

<p>4.3. pranuesi i funksioneve të deleguara, nuk ka kompetencë për funksionet e deleguara.</p> <p>5. BQK-ja me akte nënligjore, mund të përcaktojë kushte dhe kritere shtesë për delegimin e funksioneve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Mbikëqyrja e ushtrimit të funksioneve të deleguara</b></p> <p>1. Dispozitat e këtij Ligji për mbikëqyrjen e siguruesit, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për mbikëqyrjen e personit që ushtron funksionet e deleguara.</p> <p>2. Siguruesi dhe personi që ushtron funksionet e deleguara, me kërkesën e BQK-së, paraqet të dhëna mbi statusin juridik, gjendjen financiare dhe veprimtarinë e personit, e cila ka nënshkruar kontratën për delegimin e funksioneve si dhe çdo dokument dhe informacion tjetër të kërkuar nga BQK-ja.</p> <p>3. Auditori i jashtëm i siguruesit, ka të drejtë t'i kërkojë personit që ushtron funksionet e deleguara çdo informacion që lidhet me kryerjen e auditimit.</p>	<p>4.3. the receiver of delegated functions has no jurisdiction for the delegated functions.</p> <p>5. The CBK may with bylaws prescribe additional conditions and criteria for the delegation of functions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Exercising Oversight of Delegated Functions</b></p> <p>1. The provisions of this law on the supervision of insurer shall apply adequately on the person exercising the delegated functions.</p> <p>2. The insurer and the person who performs delegated functions, upon the request of the CBK presents the data on legal status, financial condition and activity of the person who has signed the contract for the delegation of functions, as well as any documents and other information required by the CBK.</p> <p>3. The external auditor of the insurer has the right to require from the person exercising delegated functions any information related to the audit performance.</p>	<p>4.3. primalac delegiranih funkcija, nema nadležnost za delegirane funkcije.</p> <p>5. CBK podzakonskim aktima može propisati dodatne uslove i kriterijume za delegiranje funkcija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Nadzor u obavljanju delegiranih Funkcija</b></p> <p>1. Odredbe ovog zakona o nadzoru osiguratelja, primenjuju se u skladu sa nadzorom nad licem koje vrši delegirane funkcije.</p> <p>2. Osiguratelj i lice koje obavlja funkcije poverene na zahtev CBK, predstavlja podatke o pravnom statusu, finansijskom stanju i aktivnostima osobe koja je potpisala ugovor za delegiranje funkcija i drugih dokumenata i informacija koje zahteva CBK.</p> <p>3. Spoljni revizor osiguratelja ima pravo da zahteva od lica koja vrše delegirane funkcije bilo kakve informacije koje se odnose na vršenje revizije.</p>
--	--	--

<p><b>KAPITULLI VI</b> <b>BASHKIMET DHE PËRVETËSIMET</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Bashkimet dhe përvetësimet e siguruesit</b></p> <p>1. Asnjë sigurues nuk mund të bashkohet me ndonjë sigurues tjetër ose të përvetësojë, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, aktiven apo të pranojë pasivën e ndonjë siguruesi tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së.</p> <p>2. Kërkesat për t'u bashkuar dhe përvetësuar aktivën apo për të pranuar pasivën e siguruesit, bëhen në formën e përcaktuar nga BQK-ja dhe shoqërohen nga informacionet të cilat kërkohen nga BQK-ja.</p> <p>3. Siguruesi i licencuar për sigurim jete, paraqet në BQK një raport të hartuar nga aktuari, që vërteton se bashkimi ose përvetësimi nuk është në kundërshtim me interesat e të siguarve dhe siguruesve të përfshirë në këto procese.</p> <p>4. Për qëllimet e vendosjes lidhur me kërkesën e parashtruar sipas këtij neni, dispozitat e këtij Ligji për licencim të siguruesve, aplikohen përshtatshëmrisht.</p> <p>5. BQK-ja para se të vendosë për bashkimin e siguruesve, mund të kërkojë mendimin e</p>	<p><b>CHAPTER VI</b> <b>MERGERS AND ACQUISITIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Mergers and Acquisitions of Insurers</b></p> <p>1. No insurer can join any other insurer or acquire either directly or indirectly, accept the assets or liabilities of any other insurer, without prior approval of the CBK.</p> <p>2. Requirements to join and acquire the assets or liabilities of the insurer are made in the form prescribed by the CBK and accompanied by the information required by the CBK.</p> <p>3. The insurer licensed for life insurance, presents to the CBK a report drafted by the actuary who certifies that the merger or acquisition is not contrary to the interests of the insured and insurers involved in those processes.</p> <p>4. For the purposes of deciding on an application filed under this section, the provisions of this law for the licensing of insurers shall apply adequately.</p> <p>5. Before deciding on the merger of the insurers the CBK may seek the opinion of the</p>	<p><b>POGLAVLJE VI</b> <b>SPAJANJA I PREUZIMANJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Spajanja i preuzimanja osiguratelja</b></p> <p>1. Nijedan osiguratelj ne može da se pridruži bilo kom drugom osiguratelju ili da preuzme, bilo direktno ili indirektno aktive/sredstva, ili da prihvati pasivu nekog drugog osiguratelja, bez prethodnog odobrenja CBK.</p> <p>2. Zahtevi za pridruživanje, preuzimanje aktiva/sredstava ili za prihvatanje pasiva osiguratelja, napravljeni su u formi propisanoj od strane CBK i sa propratnim informacijama koje zahteva CBK.</p> <p>3. Osiguratelj licenciran za životno osiguranje, predstavlja u CBK izveštaj sačinjen od strane ovlašćenog aktuara koji potvrđuje da spajanje ili preuzimanje/ akvizicija nisu u suprotnosti sa interesima osiguranika i osiguratelja koji se bave ovim procesima.</p> <p>4. Za potrebe odlučivanja o zahtevu podnetom na osnovu ovog člana, primenjuju se odredbe ovog Zakona za licenciranje osiguratelja, uz odgovarajuća prilagođavanja.</p> <p>5. CBK, pre odlučivanja o udruživanju osiguratelja, može da zatraži mišljenje agencije</p>
--	--	---

<p>agjensionit të konkurrencës.</p> <p>6. BQK-ja mund të nxjerrë rregullore tjera, në zbatimin e këtij kreu.</p> <p><b>KAPITULLI VII</b> <b>NDRYSHIMI I KAPITALI DHE EMRIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Miratimi i ndryshimeve në kapital të siguruesit</b></p> <p>1. Çdo ndryshim i kapitalit të siguruesit, i nënshtrohet aprovimit paraprak nga BQK-ja.</p> <p>2. Në rastin e rritjes së kapitalit, siguruesi dorëzon në BQK, të dhëna për burimin e kapitalit.</p> <p>3. Nëse rritja e kapitalit të siguruesit bëhet nga burime të brendshme të tij, siguruesi dorëzon në BQK të dhënat e kërkuara në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit përfshirë edhe një vërtetim të lëshuar nga auditori i jashtëm i siguruesit, që vërteton mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së siguruesit.</p> <p>4. BQK-ja mund të kërkojë rritjen e kapitalit, nëse një gjë e tillë është e nevojshme.</p>	<p>competition agency.</p> <p>6. The CBK may issue other regulations for the implementation of this chapter.</p> <p><b>CHAPTER VII</b> <b>CAPITAL AND NAME CHANGE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Approval of Changes in Equity of the Insurer</b></p> <p>1. Any change of insurer capital are subject to prior approval by the CBK.</p> <p>2. In case of the capital increase the insurer shall submit to the CBK the data on the source of the capital.</p> <p>3. If the insurer's capital increase is carried out by its internal resources, the insurer submits to the CBK the required data about the source of raising the capital, including a certificate issued by the external auditor of the insurer, certifying the adequacy of those resources within insurer's structure.</p> <p>4. The CBK may require the increase of capital, if such a thing is deemed necessary.</p>	<p>za konkurenciju.</p> <p>6. CBK može da donese druge uredbe za sprovođenje ovog poglavlja.</p> <p><b>POGLAVLJE VII</b> <b>IZMENA KAPITALA I PREIMENOVANJE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Odobranje u izmenama kapitala osiguratelja</b></p> <p>1. Svaka promena kapitala osiguratelja, podleže prethodnoj saglasnosti od CBK.</p> <p>2. U slučaju povećanja kapitala, osiguratelj je dužan da CBK preda podatke o izvoru kapitala.</p> <p>3. Ukoliko se povećanje kapitala osiguratelja obavlja iz njegovih unutrašnjih izvora, osiguratelj dostavlja potrebne podatke o izvoru podizanja kapitala u CBK, uključujući potvrde izdate od strane eksternog revizora osiguratelja, koje potvrđuju adekvatnost ovih resursa u okviru struktura osiguratelja.</p> <p>4. CBK može da zatraži povećanje kapitala, ukoliko je takvo nešto nužno.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Ndryshimi i emrit</b></p> <p>Ndryshimi i emrit të siguruesve i nënshtrohet miratimit paraprak nga BQK-ja. Siguruesi duhet t'i njoftojë të siguruarit për ndryshimin e emrit.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI VIII</b> <b>KONTRATAT E SIGURIMIT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>Change of Name</b></p> <p>The change of the name of the insurer is subject to prior approval by the CBK. The insurer must notify the insured on change of the name.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER VIII</b> <b>INSURANCE CONTRACTS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Preimenovanje</b></p> <p>Preimenovanje osiguratelja podleže prethodnoj saglasnost od CBK. Osiguratelj mora da obavesti osiguranika za promenu imena.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE VIII</b> <b>UGOVORI O OSIGURANJU</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 44</b> <b>Kontrata e sigurimit</b></p> <p>1. Kontrata e sigurimit është akti, nëpërmjet së cilit siguruesi merr përsipër rreziqe të caktuara, përkundrejt pagesës së primit, që me rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar t'i paguajë të siguruarit, përfituesit apo palës së tretë dëmshpërblimin.</p> <p>2. Kontratat e sigurimit duhet t'i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë Ligj dhe Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 44</b> <b>The Insurance Contract</b></p> <p>1. The insurance contract is the act through which the insurer undertakes certain risks, against a payment of the premium, which in case of the occurrence of the insured event, to pay policyholders, beneficiaries or third party the damages.</p> <p>2. Insurance contracts must meet the conditions set by this Law and applicable Law on the Obligation Relations.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 44</b> <b>Ugovor o osiguranju</b></p> <p>1. Ugovor o osiguranju je čin kroz koji se osiguratelj obavezuje da preuzme određene rizike, uz plaćanje premije, koji će u slučaju nastanka osiguranog slučaja platiti osiguraniku, korisniku ili trećem licu odštetu.</p> <p>2. Ugovori o osiguranju moraju da ispune uslove propisane ovim zakonom i važećim Zakonom o obligacionim odnosima.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Forma e kontratës së sigurimit</b></p> <p>1. Kontrata e sigurimit bëhet me shkrim, në formën e policës së sigurimit apo në formën e një akti tjetër të shkruar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>The Form of the Insurance Contract</b></p> <p>1. The insurance contract shall be in writing, in the form of insurance policy or in the form of another act in writing.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Oblik ugovora o osiguranju</b></p> <p>1. Ugovor o osiguranju mora biti u pisanoj formi, u obliku polise osiguranja ili u vidu nekog drugog čina pisanja.</p>

<p>2. Kërkesat dhe propozimet me shkrim të të siguruarit, drejtuar siguruesit për të lidhur një kontratë sigurimi, si dhe përgjigjet me shkrim të të siguruarit për pyetjet e bëra nga siguruesi për rrethanat e rëndësishme, që kanë të bëjnë me vlerësimin e natyrës dhe masës së rrezikut, janë pjesë përbërëse e dosjes. Në kontratë përfshihen elementet për të cilat janë dakorduar siguruesi dhe i siguruari.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Kushtet dhe përmbajtja e kontratës së sigurimit</b></p> <p>1. Kontrata e sigurimit përmban kushtet e përgjithshme, të hartuara në bazë të parimeve të mëposhtme:</p> <p>1.1. personi, i cili do të lidhë kontratën, duhet të ketë një interes të sigurueshëm dhe të pretendojë të drejtat që rrjedhin nga kontrata;</p> <p>1.2. shuma e siguruar mund të jetë deri në vlerën e interesit të sigurueshëm, por jo më e lartë se kjo vlerë, përveç se kur natyra e veprimtarisë/rrezikut e kërkon atë;</p> <p>1.3. dëmet e ndodhura si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme dhe të</p>	<p>2. Written requests and proposals of the insured addressed to the insurer, to establish an insurance contract, as well as written answers of the insurer on questions of the insured for the relevant circumstances related to the assessment of the nature and extent of the threat, are an integral part of the file. The contract includes elements that are agreed between insurer and the insured.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Terms and Content of the Insurance Contract</b></p> <p>1. The insurance contract contains general conditions drafted based upon the following principles:</p> <p>1.1. the person, who will award the contract, should have an insurable interest and to claim the rights arising under the contract;</p> <p>1.2. the insured amount can be up to the value of insurable interest, but not higher than this value, unless the nature of the activity/risk requires it;</p> <p>1.3. the claims incurred as a result of unlawful deliberate acts or omissions of the</p>	<p>2. Pisani zahtevi i predlozi osiguranika, upućenih osiguratelju, za uspostavljanje ugovora o osiguranju, kao i pisani odgovori na pitanja osiguranika od strane osiguratelja za relevantne okolnosti koje se odnose na procenu prirode i obima pretnje su sastavni deo dosijea. U ugovoru uklucujuse elementi za koje su se usaglasili osiguratel dhe osiguranik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Uslovi i sadržaj ugovora o osiguranju</b></p> <p>1. Ugovor o osiguranju sadrži opšte uslove izrađene na osnovu sledećih principa:</p> <p>1.1. osoba, koja će sklopiti ugovor, trebalo bi da ima jedan osigurani interes i da pretenduje na prava koja proizilaze iz ugovora;</p> <p>1.2. osigurani iznos može biti do vrednosti osiguranog interesa, ali ne veći od ove vrednosti, osim ako priroda delatnosti/rizik to zahtevaju;</p> <p>1.3. štete nastale kao rezultat nezakonitih i namernih radnji ili propusta osiguranika</p>
--	--	--

<p>qëllimshme të të siguarit nuk mbulohen;</p> <p>1.4. rreziqet të cilat kanë ndodhur dhe/ose dihet që kanë ndodhur, nuk mund të sigurohen;</p> <p>1.5. një interes i siguar për vlerën e tij të plotë, nuk mund të sigurohet nga i njëjti sigurues më shumë se një herë, përveç se kur siguruesi në fjalë apo siguruesi tjetër janë plotësisht të informuar dhe kanë rënë dakord për detyrimet ndaj njëri-tjetrit;</p> <p>1.6. personat, të cilët kanë përfitime monetare ose morale, në vazhdimësinë e jetës të një personi tjetër mund të sigurojnë jetën e këtij personi, vetëm me miratimin me shkrim të këtij të fundit.</p>	<p>insured are not covered;</p> <p>1.4. the risks that have occurred and/or are known to have occurred cannot be insured;</p> <p>1.5. an interest insured for its full value cannot be insured by the same insurer more than once, unless such insurer and the other insurer are fully informed and have agreed mutual obligations towards one another;</p> <p>1.6. Persons who have moral or monetary gain from the life of another person can insure this person's life only with the written consent of the latter.</p>	<p>nisu obuhvaćene;</p> <p>1.4. rizici koji su se dogodili i/ili se zna da su se desili, ne mogu se osigurati;</p> <p>1.5. osigurani interes za svoju punu vrednost, ne može se osigurati od istog osiguratelja više nego jedanput, osim ako su dotični osiguratelj ili drugi osiguratelj u potpunosti informisani i dogovorili su se o obavezama jednih prema drugima;</p> <p>1.6. lica koja imaju moralnu ili novčanu dobit, u nastavku života drugog lica mogu da osiguraju život te osobe, samo uz pismenu saglasnost ovog drugog.</p>
<p>2. Kontrata e sigurimit duhet të përmbajë:</p> <p>2.1. emrat dhe adresat e palëve;</p> <p>2.2. objektin e kontratës;</p> <p>2.3. afatin e kontratës;</p> <p>2.4. rrezikun e mbuluar dhe përjashtimet apo kufizimet e tjera të mbulimit;</p> <p>2.5. mënyrën dhe rastet e rinovimit,</p>	<p>2. The contract of insurance shall contain:</p> <p>2.1. names and addresses of the parties;</p> <p>2.2. the scope of the contract;</p> <p>2.3. terms of the contract;</p> <p>2.4. risks covered and the exclusions or limitations of coverage;</p> <p>2.5. the manner and cases of renewal</p>	<p>2. Ugovor o osiguranju treba da sadrži:</p> <p>2.1. imena i adrese stranaka;</p> <p>2.2. predmet ugovora;</p> <p>2.3. rok ugovora;</p> <p>2.4. pokriveni rizik i ostala isključivanja ili ograničenja pokriva;</p> <p>2.5. načine i slučajeve obnavljanja,</p>

<p>ndryshimit të kontratës;</p> <p>2.6. mënyrën e anulimit të pjeshëm apo në tërësi të kontratës, mënyrat e llogaritjes dhe pagesës së vlerës së përfituar nga anulimi;</p> <p>2.7. mënyrat e shkëputjes së plotë apo të pjeshme të kontratës;</p> <p>2.8. detyrimet e palëve dhe pasojat juridike të mospërbushjes së tyre;</p> <p>2.9. mënyrën dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit, si dhe pasojat e mospagimit apo pagimit të pasaktë nga ana e siguruesit;</p> <p>2.10. shuma e sigurimit, mënyra e vlerësimit të saj, si dhe kushtet e pagesës;</p> <p>2.11. primin e sigurimit dhe mënyrën e llogaritjes së tij;</p> <p>2.12. kushtet e pagesës së primit dhe pasojat e mospagimit apo pagimit të pasaktë;</p> <p>2.13. në rastin e nënshkrimit të kontratës nga ndërmjetësuesi, kontrata duhet të përmbajë: emrin, adresën dhe të dhëna të licencës së</p>	<p>change of contract;</p> <p>2.6. the manner of cancellation of a part or the whole contract, methods of calculations and payments of the gained value from the cancelation;</p> <p>2.7. ways of weaning full or partial cancelation of contract;</p> <p>2.8. obligations of the parties and the legal consequences of their non-fulfillment;</p> <p>2.9. the manner and deadlines for the payment of compensation, and the consequences of non-payment or incorrect payment by the insurer;</p> <p>2.10. insurance amount, its evaluation method and terms of payment;</p> <p>2.11. insurance premium and the manner of its calculation;</p> <p>2.12. payment conditions of the premium and the consequences of non-payment or incorrect payment;</p> <p>2.13. in case of signing the contract by the mediator, the contract should include: name, address and license of the broker;</p>	<p>izmene ugovora;</p> <p>2.6. načine delimičnog poništenja dela ili celine ugovora, i načine proračuna i plaćanja vrednosti u zadobijene od poništavanja;</p> <p>2.7. načine o potpunom ili delimičnom poništavanju ugovora;</p> <p>2.8. obaveze stranaka i pravne posledice njihovog neispunjavanja;</p> <p>2.9. načine i rokove za plaćanje naknade, kao i posledice neplaćanja ili nepravilnog plaćanja od strane osiguratelja;</p> <p>2.10. iznos osiguranja, način njegove procene i uslove plaćanja;</p> <p>2.11. premiju osiguranja i način njenog obračuna;</p> <p>2.12. uslove plaćanja premije i posledice neplaćanja ili nepravilnog plaćanja;</p> <p>2.13. u slučaju potpisivanja ugovora od strane posrednika/brokera, ugovor treba da sadrži: ime, adresu i licencu brokera;</p>
---	---	---



<p>ndërmjetësuesit;</p> <p>2.14. datën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës;</p> <p>2.15. detyrimet e të siguarit në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguar dhe barra e tij e provës;</p> <p>2.16. rregulla për kapitalizmin e anuiteteve në rastin e sigurimit të sëmundjeve, aksidenteve dhe palëve të treta, nëse ato shoqërohen me pagesa anuitetesh;</p> <p>2.17. rregullat e zgjidhjes jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe procedurat e ankesës; si dhe</p>	<p>2.14. date and place of signing the contract;</p> <p>2.15. obligations of the policyholder in the event of the occurrence of the insured event and his burden of proof;</p> <p>2.16. rules for annuities capitalization in case of illness, accident and third parties insurance, if they are associated with annuity payments;</p> <p>2.17. rules for out of court settlement of disputes and complaint procedures, and</p>	<p>2.14. datum i mesto potpisivanja ugovora;</p> <p>2.15. obaveze osiguranika u slučaju nastanka osiguranog slučaja i njegovog tereta dokazivanja;</p> <p>2.16. pravila za kapitalizaciju anuiteta u slučaju osiguranja bolesti, nesreća i trećih lica, ako su ona propraćena isplatom anuiteta;</p> <p>2.17. pravila za vansudsko rešavanje sporova i žalbenih postuaka, kao i</p>
<p>3. Kontratës së sigurimit mund t'i shtohen edhe kushte të veçanta, që lidhen me çështje specifike, të cilat nuk bien në kundërshtim me parimet e përmendura në këtë nen.</p>	<p>3. Special conditions may be added to the insurance contract related to specific issues, which are not inconsistent with the principles mentioned in this article.</p>	<p>3. Ugovoru o osiguranju mogu se pridodati posebni uslovi u vezi određenih pitanja, koja nisu u skladu sa principima navedenim u ovom članu.</p>
<p>4. Kushtet e përgjithshme publikohen në faqen e internetit të siguresit.</p>	<p>4. General conditions are published on the website of the insurer.</p>	<p>4. Opšti uslovi se objavljuju na internet stranici osiguratelja.</p>
<p>5. Kushtet e përgjithshme të pranuar nga i siguaruari, janë pjesë integrale e kontratës së sigurimit. Në rast të mospërputhjes së kushteve të veçanta të kontratës së sigurimit me kushtet e përgjithshme, dispozitat e kushteve të veçanta,</p>	<p>5. General conditions accepted by the insured, are an integral part of the insurance contract. In case of discrepancies of the special conditions of the insurance contract with the general conditions, the provisions of the special</p>	<p>5. Opšti uslovi prihvaćeni od osiguranika su sastavni deo ugovora o osiguranju. U slučaju neslaganja posebnih uslova ugovora o osiguranju sa opštim uslovima, odredbe posebnih uslova, koje su navedene u ugovoru</p>

<p>të cilat janë të përcaktuara në kontratë, do të mbizotërojnë.</p>	<p>conditions, which are specified in the contract shall prevail .</p>	<p>će preovladati.</p>
<p>6. Siguruesi detyrohet të informojë klientët për kushtet e përgjithshme të sigurimit, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit. Pyetësorit të hartuar nga siguruesi i bashkëngjiten edhe kushtet e përgjithshme.</p>	<p>6. The insurer is obliged to inform customers about the general conditions of insurance before signing the insurance contract. The general conditions are attached a questionnaire drafted by the insurer.</p>	<p>6. Osiguratelj je dužan da obavesti klijente o opštim uslovima osiguranja pre potpisivanja ugovora o osiguranju. Upitniku izrađenom od strane osiguratelja, prilažu se i opšti uslovi.</p>
<p>7. Çdo ndryshim apo zëvendësim i kushteve të përgjithshme ose hartim i ri i tyre, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit është i vlefshëm dhe i detyrueshëm për të siguruarin, vetëm nëse për atë ndryshim ose zëvendësim të kushteve të përgjithshme të kontratës, i siguruari njoftohet paraprakisht dhe për të cilat ka dhënë miratimin me shkrim.</p>	<p>7. Any changes or replacement of general conditions or their new drafting, during the period of validity of the insurance contract is valid and binding for the insured, unless for the modification or replacement of the general conditions of the contract the insured notified in advance and has given written approval.</p>	<p>7. Sve promene ili zamene opštih uslova ili njihova nova izrada, u periodu važenja ugovora o osiguranju, važe i obavezujuće su za osiguranika, osim ako za tu modifikaciju ili zamenu opštih uslova ugovora, osiguranik bude obavešten unapred i za koje da pismenu saglasnost.</p>
<p>8. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit duhet të jenë të shkruara qartë dhe lehtësisht të kuptueshme.</p>	<p>8. General and specific conditions of insurance contract must be clearly written and easily understandable.</p>	<p>8. Opšti i specifični uslovi ugovora o osiguranju moraju biti jasno napisani i lako razumljivi.</p>
<p>9. Kushtet e kontratës së sigurimit, nuk duhet të jenë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, praktikat në fushën e sigurimeve dhe parimet e ndershmërisë dhe mirëbesimit. Mbulimi i përcaktuar në kontratën e sigurimit, duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe të saktë, me qëllim që të parandalohet çorientimi dhe mashtrimi, si dhe të mos shkelen të drejtat dhe përfitimet e të siguruarit. Përveç</p>	<p>9. The terms of the insurance contract should not be contrary to the provisions of the legislation in force in the field of insurance practices and principles of honesty and trust. Coverage specified in the insurance contract must be expressed clearly and accurately, in order to prevent disorientation and delusion, and not violate the rights and benefits of the insured. Besides the risk cover, the insurance</p>	<p>9. Uslovi ugovora o osiguranju ne bi trebalo da budu u suprotnosti sa odredbama zakona na snazi u oblasti prakse osiguranja i principima poštenja i poverenja. Pokrivenost navedena u ugovoru o osiguranju mora biti jasno i precizno izražena, u cilju sprečavanja dezorijentacije i prevare, kao i da se ne prekrše prava i koristi osiguranika. Pored pokrivanja rizika, ugovor o osiguranju mora navesti jasno i isključujuće</p>

<p>rrezikut të mbuluar, kontrata e sigurimit duhet të shprehë qartë edhe rreziqet e përjashtuara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Kontrata e sigurimit të jetës</b></p> <p>1. Kontrata e sigurimi të jetës duhet t'i përmbushin kushtet dhe të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.</p> <p>2. Procedurat dhe çështjet teknike për kontratën e sigurimit të jetës, përcaktohen në rregullore të miratuara nga BQK-ja.</p>	<p>contract must state clearly also the excluded risk.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Life Insurance Contracts</b></p> <p>1. Life insurance contract must meet the requirements and comply with the provisions of the Law on Obligations.</p> <p>2. The procedures and technical issues for the life insurance contract are defined in regulations adopted by the CBK.</p>	<p>rizike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Ugovor o životnom osiguranju</b></p> <p>1. Ugovor o životnom osiguranju mora da ispunjava uslove i u skladu sa odredbama Zakona o obligacionim odnosima.</p> <p>2. Procedure i tehnička pitanja za ugovor o osiguranju života, definisana u propisima koje je donela CBK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 48</b> <b>Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim dhe pagesa e dëmshpërblimit</b></p> <p>1. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar, siguruesi është i detyruar t'i japë të siguruarit dëmshpërblimin deri në shumën e siguruar.</p> <p>2. Siguruesi trajton çdo kërkesë për dëmshpërblim, si dhe kryen pagesën në masën e duhur dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratën e sigurimit.</p> <p>3. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim nga ana e siguruesit, përfshin edhe vlerësimin e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 48</b> <b>Handling of Claims for Damages and Compensation Payments</b></p> <p>1. In case of occurrence of the insured event, the insurer is obligated to provide compensation to policyholders up to the insured amount.</p> <p>2. The insurer handles any claim for damages, and makes payment to the extent appropriate and within the time specified in the insurance contract.</p> <p>3. The processing of requests for indemnification by the insured includes a</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 48</b> <b>Obrada zahteva za odštetu i isplata odšteta</b></p> <p>1. U slučaju nastanka osiguranog slučaja, osiguratelj je u obavezi da obezbedi odštetu za osigurane sume osiguranja.</p> <p>2. Osiguratelj obrađuje svaki zahtev za naknadu štete, kao i izvršava uplatu u odgovarajućoj meri i u navedenom roku u ugovoru o osuranju.</p> <p>3. Obrada zahteva za odštetu od strane osiguratelja, uključuje i procenjivanje štete od</p>

<p>dëmeve nga vetë siguruesi.</p> <p>4. Kërkesat për dëmshpërblim trajtohen nga siguruesi në kohë, në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe transparente.</p> <p>5. Siguruesi krijon një sistem të brendshëm për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, si dhe harton dhe miraton procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave.</p> <p>6. Siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shumën, e cila tejkalon kufirin e shumës së sigurimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga palët në kontratë.</p>	<p>personal assessment of damages by the insured.</p> <p>4. The compensation of claims is handled by the insurer on timely, impartial, fair and transparent manner.</p> <p>5. The insurer creates an internal system for handling compensation claims, as well as establishes and adopts internal procedures for handling and resolving those claims.</p> <p>6. The insurer is not liable to pay the amount, which exceeds the amount of the insurance, unless otherwise stipulated by the parties to the contract.</p>	<p>samog osiguranika.</p> <p>4. Zahtevi za naknadu štete se mogu obraditi pravovremeno od osiguratelja, na nepristrasan, pravičan i transparentan način.</p> <p>5. Osiguratelj stvara interni sistem za obradu zahteva za nadoknadu štete, kao i izrađuje i usvaja interne procedure za obradu i rešavanje ovih zahteva.</p> <p>6. Osiguratelj nije obavezan da plati iznos koji premašuje iznos osiguranja, osim ako nije drugačije predviđeno od stranaka u ugovoru.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Parimet e përgjithshme të detyrimit për informim</b></p> <p>1. Siguruesi dhe ndërmjetësuesit duhet të informojnë të sigruarin përpara nënshkrimit të kontratës në lidhje me subjektin e sigurimit, mbulimin dhe çështje të tjera. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës të vlefshmërisë së kontratës.</p> <p>2. Për informatat nga paragrafi 1 i këtij neni siguruesi informon me shkrim personin që ka nënshkruar kontratën e sigurimit. Ai garanton</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>General Principles of Liability for Information</b></p> <p>1. The insurer and the broker must inform the insured before signing the contract regarding the subject of insurance coverage and other issues. Obligations on information will initiate before signing the contract, and continues throughout the period of validity of the contract.</p> <p>2. For the information under paragraph 1 of this article the insurer shall inform in writing the person who has signed the insurance</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Opšti principi obaveze za informisanje</b></p> <p>1. Osiguratelj i broker moraju obavestiti osiguranika pre potpisivanja ugovora o predmetu osiguranja i drugim pitanjima. Obelodanjivanje obaveze počinje pre potpisivanja ugovora i nastavlja se tokom celog perioda važenja ugovora.</p> <p>2. O informacijama iz stava 1 ovog clana, osiguratelj će pismeno obavestiti lice koje je potpisalo ugovor o osiguranju. On garantuje da</p>

<p>që informacioni i komunikuar palëve të jetë i mjaftueshëm.</p> <p>3. Siguruesi para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, duke u mbështetur në parimin e mirëbesimit, ndihmon klientin për të kuptuar aspektet teknike të mbulimit të sigurimit dhe elementet e tjera të kontratës së sigurimit, nëpërmjet dhënies së informacionit me gojë dhe me shkrim, duke mos vepruar në mënyrë mashtruese dhe çorientuese.</p> <p>4. Siguruesi para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës informon klientin për çdo konflikt interesi që mund të ketë me një palë tjetër, duke përfshirë të gjitha lidhjet ekonomike dhe juridike, të cilat ndikojnë në përmbushjen e detyrimeve të siguruesit ndaj klientit.</p> <p>5. Të gjitha detyrimet e siguruesit para nënshkrimit dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës zbatohen edhe për ndërmjetësuesit.</p> <p>6. Siguruesi përmbush detyrimin për informim edhe ndaj personave të tjerë, që përfitojnë nga kontrata e sigurimit, në rast se kërkohet nga këta persona.</p>	<p>contract. It guarantees that the information communicated to the parties is sufficient.</p> <p>3. Before signing and during the period of validity of the contract, based on the principle of good faith, the Insurer helps the client to understand the technical aspects of insurance coverage and other elements of the insurance contract, through providing information orally and in writing, by not acting fraudulently and misleadingly.</p> <p>4. Before signing and during the contract validity period the insurer shall inform the client of any conflict of interest that may have with another party, including all legal and economic connections, which affect the performance of the insurer's obligations to the client .</p> <p>5. All obligations of the insurer before signing and during the contract validity period shall also apply to intermediaries.</p> <p>6. The insurer fulfills the obligation to inform the other persons who benefit from the insurance contract, if required by such persons.</p>	<p>informacija saopštena strankama bude dovoljna.</p> <p>3. Osiguratelj pre potpisivanja i tokom perioda važenja ugovora, na osnovu principa poverenja, pomaže klijentu da razume tehničke aspekte pokrivenosti osiguranja i druge elemente ugovora o osiguranju, kroz pružanje informacija usmeno i pismeno, ne delujući na lažan i obmanjujući način.</p> <p>4. Osiguratelj pre potpisivanja i tokom perioda važenja ugovora obavestiće klijenta za bilo kakav sukob interesa koji mogu imati sa drugom stranom, uključujući sve pravne i ekonomske veze, koje utiču na ispunjavanje obaveza osiguratelja prema klijentu.</p> <p>5. Sve obaveze osiguratelja pre potpisivanja i tokom perioda važenja ugovora primenjuju se i na posrednike/brokere.</p> <p>6. Osiguratelj ispunjava obavezu da informiše druga lica koja imaju koristi od ugovora o osiguranju, ako se to zahteva od tih lica.</p>
--	--	---

<p align="center"><b>Neni 50</b></p> <p align="center"><b>Detyrimi për informim përpara nënshkrimit të kontratës</b></p>	<p align="center"><b>Article 50</b></p> <p align="center"><b>Liability for Information before Signing the Contract</b></p>	<p align="center"><b>Član 50</b></p> <p align="center"><b>Obaveza informisanja pre potpisivanja ugovora</b></p>
<p>1. Siguruesi dhe ndërmjetësuesit detyrohen t'i japin me shkrim çdo klienti përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm, në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion duhet të përmbajë:</p> <p>1.1. emrin e siguruesit, si dhe adresën e selisë qendrore të siguruesit;</p> <p>1.2. adresën e selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet nënshkrimi i kontratës së sigurimit;</p> <p>1.3. procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për trajtimin e tyre;</p> <p>1.4. rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës në përputhje me kushtet e përgjithshme;</p> <p>1.5. afatet dhe mënyrat e zgjidhjes dhe përfundimit të kontratës;</p> <p>1.6. metodat e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mos</p>	<p>1. The insurer and the broker must give in writing to every client all necessary information, before signing the insurance contract, regarding the relevant type of insurance. This information should contain:</p> <p>1.1. the name of the insurer, and headquarters address of the insurer;</p> <p>1.2. the address of the branch headquarters, through which the signing of the insurance contract is done;</p> <p>1.3. the internal procedures of handling requests for compensation, and the structure responsible for their treatment;</p> <p>1.4. the covered and excluded risks, as well as the possibilities for changing the contract in accordance with the general conditions;</p> <p>1.5. the terms and modes of settlement and termination of the contract;</p> <p>1.6. methods of calculating the premium, terms and payment of contract, the</p>	<p>1. Osiguratelj i broker su obavezni da napismeno daju svakom klijentu pre potpisivanja ugovora o osiguranju, svu potrebnu informaciju, u pogledu relevantne vrste osiguranja. Ova informacija treba da sadrži:</p> <p>1.1. naziv osiguratelja, kao i adresu centralnog sedišta osiguratelja;</p> <p>1.2. adresu centralnog sedišta filijale preko koje se vrši potpisivanje ugovora o osiguranju;</p> <p>1.3. interne procedure obrade zahteva za naknadu, kao i strukture odgovorne za njihovu obradu;</p> <p>1.4. pokrivene rizike i one isključivanja, i mogućnosti za promenu ugovora u skladu sa opštim uslovima;</p> <p>1.5. rokove i načine rešavanja i raskida ugovora;</p> <p>1.6. metode izračunavanja premije, rokove i načine njenog plaćanja, posledica</p>

<p>pagesës së primit, si dhe masat e primit që i korrespondojnë mbulimit bazë dhe shtesë;</p> <p>1.7. kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit dhe shumës së sigurimit;</p> <p>1.8. metodat e llogaritjes dhe shpërndarjes të bonuseve, nëse ka;</p> <p>1.9. procedurat jashtë gjyqësore, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;</p> <p>1.10. kushtet për zgjidhjen e njëanshme të kontratës;</p> <p>1.11. të dhëna të përgjithshëm për obligimet tatimore dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit.</p> <p>2. Përrjashtimisht nga përcaktimi i paragrafit 1. të këtij neni, informacioni në fjalë mund të jepet me gojë nëse kërkohet nga klienti, nëse ky i fundit kërkon mbulim të menjëhershëm. Në këtë rast menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, siguruesi i jep konsumatorit edhe informacionin me shkrim. Nënshkrimi i kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve</p>	<p>consequences of premium non-payment and premium measures that correspond to the basic and additional coverage;</p> <p>1.7. requirements and deadlines for the payment of compensation and the amount of insurance;</p> <p>1.8. methods of calculation and distribution of bonuses, if any;</p> <p>1.9. extra-judicial procedures for resolving disputes between the parties with respect to the insurance contract, in accordance with the internal rules of the insurer without affecting the right of appeal to the court;</p> <p>1.10. conditions for solving unilateral contract;</p> <p>1.11. general data on tax liabilities and commissions related to the insurance contract.</p> <p>2. Excluded from the definition of paragraph 1 of this section, such information may be given orally if requested by the client, if the latter requires immediate coverage. In this case, immediately after signing the contract, the insurer gives the consumer the information in writing. Signing of the insurance contract, its annexes or conditions means agreeing with the</p>	<p>neplaćanja premije, kao i mere premije koje odgovaraju osnovnom i dodatnom pokrivanju;</p> <p>1.7. zahteve i rokove za isplatu naknade i iznos osiguranja;</p> <p>1.8. metode obračuna i raspodele bonusa, ako postoji;</p> <p>1.9. vansudske postupke, za rešavanje sporova između stranaka u pogledu ugovora o osiguranju, u skladu sa internim pravilima osiguratelja bez uticaja na pravo žalbe sudu;</p> <p>1.10. uslove za jednostrano rešavanje ugovora;</p> <p>1.11. opšte podatke za poreske obaveze i naknade u vezi sa ugovorom o osiguranju.</p> <p>2. Izuzimajući definicije iz stava 1. ovog člana, dotična informacija može da se da usmeno ako se zahteva od klijenta, ukoliko ovaj poslednji zahteva trenutnu pokrivenost. U tom slučaju, odmah nakon potpisivanja ugovora, osiguratelj daje klijentu informaciju u pisanoj formi. Potpisivanje ugovora o osiguranju, odnosno njegovih aneksa i uslova, znači slaganje sa</p>
--	---	---

<p>të saj, nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë me gojë dhe pranimin e kushteve të saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Informacioni i detyrueshëm në gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës</b></p> <p>1. Siguruesi dhe ndërmjetësuesit do të informojnë të siguruarin për çdo ndryshim të legjislacionit të sigurimeve, likuidimit, bashkimit apo mbylljes së siguruesit në çdo lloj mënyre, revokimit të licencës për një klasë të caktuar apo të gjitha klasat e sigurimit, si dhe për çdo ndryshim apo ngjarje tjetër, e cila ndikon në të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, brenda 10 ditësh kalendarike nga data e ndodhjes së ngjarjes.</p> <p>2. Siguruesi dhe ndërmjetësuesi do të përmbushin detyrimin për informim, gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, nëpërmjet faqes zyrtare, postës, faksit, postës elektronike apo mënyrave tjera të komunikimit të pranueshme për BQK-në.</p> <p>3. Detyrimi për informim mund të kryhet përmes telefonit, nëse biseda telefonike regjistrohet nga një mjet magnetik apo digjital, në mënyrë që siguruesi të mund ta vërtetojë këtë gjë.</p>	<p>information given orally and acceptance of its terms.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 51</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Mandatory Information during the Period of Validity of the Contract</b></p> <p>1. The insurer and the broker will inform the insured of any changes to insurance legislation, liquidation, merger, or closure of the insurer in any way, the revocation of license for a certain class or all classes of insurance, and any change or another event, which affect the rights and obligations of the insured, within 10 calendar days from the date of the occurrence.</p> <p>2. The insurer and the broker will comply with the obligation to information, during the period of validity of the contract, via the official website, mail, fax, email, or other means of communication acceptable to CBK.</p> <p>3. The liability for information can be made via phone, if telephone conversations are recorded by a magnetic or digital means, so that the insurer can prove it.</p>	<p>informacijama datim usmeno i prihvatanje njegovih uslova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 51</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Obavezna informacija tokom perioda važenja ugovora</b></p> <p>1. Osiguratelj i broker će obavestiti osiguranika o bilo kakvoj promeni zakonodavstva osiguranja, likvidaciji, spajanju ili zatvaranju osiguratelja na bilo koji način, o oduzimanju dozvole za određene klase ili sve vrste osiguranja, kao i bilo kakvoj promeni ili drugim dešavanjima koja utiču na prava i obaveze osiguranika, u roku od 10 kalendarskih dana od dana događaja.</p> <p>2. Osiguratelj i posrednik će poštovati obavezu za informisanje, u periodu važenja ugovora, preko zvaničnog sajta, maila, faksa, e-maila ili drugih sredstava komunikacije prihvatljivih za CBK.</p> <p>3. Obaveza za informaciju može se izvršiti putem telefona, ako telefonski razgovori budu snimljeni jednom magnetnom ili digitalnom uređaju, tako da osiguratelj to može dokazati.</p>
---	---	---



<p align="center"><b>Neni 52</b> <b>Kontrata e bashkësigurimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 52</b> <b>Coinsurance Contract</b></p>	<p align="center"><b>Član 52</b> <b>Ugovor o saosiguranju</b></p>
<p>1. Përmes një kontrate bashkësigurimi, dy apo më shumë sigurues bashkësigurojnë rreziqet nga llojet e sigurimit, për të cilat ka licencë nga BQK-ja.</p> <p>2. Siguruesit shpërndajnë ndërmjet tyre përgjegjësitë e ndërmarra nëpërmjet një kontrate sigurimi, të nënshkruar nga ata.</p> <p>3. Palët në një kontratë bashkësigurimi, duhet të përcaktojnë:</p> <p>3.1. siguruesin kryesor;</p> <p>3.2. pjesën përkatëse, për të cilat siguruesit marrin përsipër përgjegjësitë;</p> <p>3.3. shpërndarjen e primeve të sigurimit;</p> <p>3.4. kushtet e përgjithshme të zbatueshme.</p> <p>4. Çdo marrëdhënie me të siguarin sipas kontratës së sigurimit, kryhet nga siguruesi kryesor, përveçse kur është përcaktuar ndryshe. Siguruesi kryesor është përgjegjës për kontratën në emër dhe për llogari të të gjithë bashkësiguruesve.</p>	<p>1. Through a coinsurance contract, two or more insurers coinsure types of insurance risks, which have a license from CBK.</p> <p>2. The insurers share s, among themselves, responsibilities undertaken through an insurance contract, signed by them.</p> <p>3. In a coinsurance contract parties must specify:</p> <p>3.1. primary insurer;</p> <p>3.2. the relevant part, for which insurers assume responsibility;</p> <p>3.3. the distribution of insurance premiums;</p> <p>3.4. the general conditions applicable.</p> <p>4. Any relationship with the insured under the insurance contract, is performed by leading insurer, unless specified otherwise. Leading insurer is responsible for the contract in the name and on behalf of all coinsurers.</p>	<p>1. Kroz ugovor o saosiguranju, dva ili više osiguratelja saosiguravaju rizike od vrste osiguranja, za koje imaju licencu od CBK.</p> <p>2. Osiguratelji raspoređuju među sobom odgovornosti koje se preduzimaju preko ugovora o osiguranju, potpisanog od njihove strane.</p> <p>3. Strane u ugovoru saosiguranja moraju da odrede:</p> <p>3.1. primarnog osiguratelja;</p> <p>3.2. relevantni deo, za koji osiguravajuća društva preuzmaju odgovornost;</p> <p>3.3. distribuciju premija osiguranja;</p> <p>3.4. opšte primenljive uslove.</p> <p>4. Svaki odnos sa osiguranikom na osnovu ugovora o osiguranju, vrši se od glavnog osiguratelja, osim ako nije drugačije naznačeno. Glavni osiguratelj je odgovoran za ugovor u ime i za račun svih saosigurača.</p>

<p>5. Siguruesi kryesor, informon të siguararin për rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, në raste kur këto rrethana nuk janë të shprehura në kontratën e sigurimit.</p> <p>6. Pasi i siguruari ka marrë njoftimin sipas paragrafit 5. të këtij neni, çdo bashkësigurues është përgjegjës për pjesën e tij, në përputhje me masën e përgjegjësive të marra përsipër, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata e sigurimit.</p> <p>7. BQK-ja mund të miratojë rregulla të veçanta, në lidhje me kontratën e bashkësigurimit.</p>	<p>5. The principal insurer informs the insured about the circumstances set out in paragraph 2 of this section, in cases where those conditions are not expressed in the insurance contract.</p> <p>6. Once the insurer has received notice under paragraph 5 of this section, any coinsurer is responsible for his part, in accordance with the extent of the responsibilities assumed, unless otherwise provided by the contract of insurance.</p> <p>7. The CBK may adopt special rules in relation to the coinsurance contract.</p>	<p>5. Glavni osiguratelj obaveštava osiguranika o okolnostima navedenim u stavu 2. ovog člana, u slučajevima kada ti uslovi nisu izraženi u ugovoru o osiguranju.</p> <p>6. Kada je osiguratelj primio obaveštenje iz stava 5. ovog člana, svaki saosiguratelj je odgovoran za svoj deo, u skladu sa stepenom preuzetih odgovornosti, osim ako nije drugačije predviđeno ugovorom o osiguranju.</p> <p>7. CBK može usvojiti posebna pravila u vezi sa ugovorom o saosiguranju.</p>
<p><b>KAPITULLI IX</b> <b>KUJDESI DHE MBROJTJA E</b> <b>KONSUMATORIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 53</b> <b>Informimi i publikut</b></p>	<p><b>CHAPTER IX</b> <b>CUSTOMER CARE AND PROTECTION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 53</b> <b>Informing the Public</b></p>	<p><b>POGLAVLJE IX</b> <b>BRIGA I ZAŠTITA POTROŠAČA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 53</b> <b>Informisanje javnosti</b></p>
<p>1. Siguruesi merr të gjitha masat teknike dhe administrative për të krijuar infrastrukturën e teknologjisë informative, në përputhje me kërkesat nga BQK-ja, për informimin e të siguararit apo personave të tjerë të interesuar për sa i përket zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në sektorin e sigurimeve.</p> <p>2. Siguruesi përgatit faqe interneti me format</p>	<p>1. The insurer takes all technical and administrative measures to create information technology infrastructure, in accordance with the requirements by CBK, to inform the insured or other interested persons regarding legal developments and changes in the insurance sector.</p> <p>2. The insurer prepares website in an easily</p>	<p>1. Osiguratelj preuzima sve tehničke i administrativne mere za stvaranje infrastrukture informacione tehnologije, u skladu sa zahtevima CBK za informisanje osiguranika ili drugih zainteresovanih lica u vezi zakonskih razvoja i promena u sektoru osiguranja.</p> <p>2. Osiguratelj priprema internet stranicu, sa</p>

<p>lehtësisht të lexueshëm dhe që do të përmbajë së paku informacionet në vijim:</p> <p>2.1. informacione të përgjithshme rreth siguruesit, aksionarëve dhe strukturës administrative, kapitalit të siguruesit;</p> <p>2.2. klasat e sigurimit, shërbimet e sigurimit dhe produktet e ofruara për ato klasa;</p> <p>2.3. informacione për kushtet e veçanta, rreziqet dhe mbulimet që nuk ofrohen rregullisht për një produkt sigurimi, por që mund të përfshihen si shtesë në dispozitat e kushteve të veçanta;</p> <p>2.4. informacione për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarve dhe palëve të tjera, si dhe për procedurën që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar;</p> <p>2.5. informacionin provizionet e zbatueshme;</p> <p>2.6. adresa, posta elektronike, numri i telefonit dhe faksit të të gjitha njësive të siguruesit, përfshirë edhe atë të selisë qendrore të saj;</p> <p>2.7. procedurën për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim;</p>	<p>readable format, and will contain at least the following information:</p> <p>2.1. general information about the insurer, shareholders and administrative structure, capital of the insurer;</p> <p>2.2. the insurance classes, insurance services and products offered to those classes;</p> <p>2.3. information on specific conditions, risks and coverage which is not provided regularly for an insurance product, but that may be included in addition to the provisions of the special conditions;</p> <p>2.4. information on the rights and obligations of the insured and other parties, as well as the procedure to be followed in case of the occurrence of the insured event;</p> <p>2.5. information on applicable provisions;</p> <p>2.6. address, email, phone and fax numbers of all units of insurers, including those of the main headquarter;</p> <p>2.7. procedure for handling compensation claim;</p>	<p>lako čitljivim formatom i koja će sadržati najmanje sledeće podatke:</p> <p>2.1. opšte informacije o osiguratelju, deoničarima i administrativnim strukturama i kapitalu osiguratelja;</p> <p>2.2. klase osiguranja, usluge osiguranja i proizvode koji se nude za te klase;</p> <p>2.3. informacije o specifičnim uslovima, rizicima i pokrića koja se ne pružaju redovno za jedan proizvod osiguranja, ali mogu biti obuhvaćeni kao prilog u odredbama posebnih uslova;</p> <p>2.4. informacije o pravima i obavezama osiguranika kao i drugih strana, kao i postupak koji treba slediti u slučaju nastanka osiguranog slučaja;</p> <p>2.5. informacije o važećim provizijama;</p> <p>2.6. adresu, elektronsku poštu, brojeve telefona i faksa svih jedinica osiguratelja, uključujući i svoje glavno sedište;</p> <p>2.7. postupak za obradu zahteva za obeštećenje;</p>
---	--	--

<p>2.8. formularët elektronikë që i lejojnë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, të bëjnë kërkesa për informacion dhe dëmshpërblim nëpërmjet internetit;</p> <p>2.9. statistika dhe informacione të tjera të rëndësishme;</p> <p>2.10. pasqyrat financiare më të fundit të audituara së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm</p> <p>3. Siguruesi krijon infrastrukturën e teknologjisë informative që t'i mundësojë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë të përditësuar përmes internetit, informacionin që lidhet me kontratën e sigurimit.</p> <p>4. BQK-ja mund të përcaktoj edhe të dhëna tjera që duhet të publikohen sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.</p> <p>5. BQK-ja mund t'i publikojë në faqen zyrtare të saj të dhënat nga ky nen dhe të dhënat e tjera shtesë sipas vlerësimit të saj.</p>	<p>2.8. electronic forms which allow policyholders and other interested parties to make requests for information and damage compensation via the Internet;</p> <p>2.9. statistics and other relevant information;</p> <p>2.10. the most recent audited financial statements along with the external auditor opinion.</p> <p>3. The insurer provides information technology infrastructure that enable policyholders and other interested parties, in order to update via the Internet information related to the insurance contract.</p> <p>4. The CBK may also determine other information that must be published pursuant to paragraphs 2 and 3 of this article.</p> <p>5. The CBK may publish on its official website the information from this article and other data collections, according to its assessment .</p>	<p>2.8. elektronske obrasce koje omogućavaju osiguranicima i drugim zainteresovanim stranama da dostave zahteve za informacije i obeštećenje putem interneta;</p> <p>2.9. statistike i druge važne informacije;</p> <p>2.10. najnovije revidirane finansijske izveštaje, zajedno sa mišljenjem spoljnog revizora.</p> <p>3. Osiguratelj stvara infrastrukturu informacione tehnologije kako bi omogućio osiguraniku i drugimzainteresovanim stranama, ažuriranu putem interneta, informaciju u vezi ugovora o osiguranju.</p> <p>4. CBK može takođe odrediti i druge podatke koji moraju biti objavljeni u skladu sa stavovima 2. i 3. ovog člana.</p> <p>5. CBK može da objavi na svojoj zvaničnoj internet stranici podatke iz ovog člana i druge dodatne podatke, prema svojoj proceni.</p>
--	--	--

<p align="center"><b>Neni 54</b> <b>E drejta për ankesë</b></p>	<p align="center"><b>Article 54</b> <b>Right to appeal</b></p>	<p align="center"><b>Član 54</b> <b>Pravo na žalbu</b></p>
<p>1. Nëse i siguruari gjykon se siguruesi nuk i përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit, ai mund të paraqesë një ankesë pranë siguruesit.</p> <p>2. Siguruesi i përgjigjet çdo ankesë të dorëzuar me shkrim apo në formë elektronike nga i siguruari apo persona të tjerë të interesuar dhe jep çdo informacion të kërkuar, që ka lidhje me kontratën e sigurimit.</p> <p>3. Siguruesi duhet të krijojë një sistem të brendshëm për trajtimin e ankesave dhe procedura të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre ankesave.</p> <p>4. Ankesat e të siguarve trajtohen në mënyrë të paanshme dhe brenda afatit të përcaktuar me akte nënligjore.</p> <p>5. I siguruari ka të drejtë t'i drejtohet BQK-së për çdo pakënaqësi të trajtimit të ankesës së tij nga siguruesi. I siguruari mund t'i drejtohet BQK-së edhe për ankesa ndaj ndërmjetësuesve të sigurimeve apo vlerësuesve të dëmeve apo profesionisteve tjerë të sigurimeve.</p> <p>6. BQK-ja kur e vlerëson të nevojshme i kthen</p>	<p>1. If the insured finds that the insurer does not comply with the conditions set in the contract of insurance, he may file a complaint with the insurer.</p> <p>2. The Insurer responds to every complaint submitted in written or in electronic form by the insured or other persons interested and provides any information requested related to the insurance contract.</p> <p>3. The insurer must establish an internal system for handling complaints and internal procedures for handling and resolving these complaints.</p> <p>4. Complaints of the insured are treated impartially and within the time specified by bylaws.</p> <p>5. The insured has the right to address the CBK for any dissatisfaction regarding handling of his complaint by the insurer. The insured can address the CBK for complaints against insurance intermediaries or loss adjustors or other insurance professionals.</p> <p>6. When deemed necessary the CBK returns</p>	<p>1. Ako osiguranik proceni da se osiguratelj ne podržava navedenih uslova u ugovoru o osiguranju, on može da uloži žalbu kod osiguratelja.</p> <p>2. Osiguratelj odgovara na svaku podnetu žalbu u pisanoj ili elektronskoj formi od strane osiguranika ili drugih zainteresovanih lica i daje svaku traženu informaciju koja je u vezi sa ugovorom o osiguranju.</p> <p>3. Osiguratelj mora da uspostavi unutrašnji sistem za razmatranje žalbi i interne procedure za razmatranje i rešavanje ovih žalbi.</p> <p>4. Žalbe osiguranika se razmatraju nepristrasno i u roku navedenom podzakonskim aktima.</p> <p>5. Osiguranik ima pravo da se obrati CBK za svako nezadovoljstvo prilikom razmatranja njegove žalbe od strane osiguratelja. Osiguranik se može obratiti CBK i za žalbe protiv posrednika u osiguranju ili procenivača štete ili drugih stručnjaka za osiguranje.</p> <p>6. Kada CBK smatra potrebnim, vraća žalbu</p>

<p>për rishqyrtim siguruesit çështjen e ankimuar. BQK-ja brenda kompetencave të saj mbikëqyrëse, vlerëson nëse siguruesi zbaton praktikat më të mira, rregullat profesionale, kërkesat e ligjit dhe kushtet e kontratës së sigurimit.</p> <p>7. Procedurat dhe shqyrtimi i ankimimit në BQK përcaktohen me rregullore.</p> <p>8. BQK-ja do të mbajë statistika për ankesat që pranon nga policëmbajtësit</p>	<p>for insurers review the case of complaint. Within its supervisory powers the CBK assesses whether the insurer implements best practices, professional rules, the requirements of the law and the terms of the insurance contract.</p> <p>7. Complaint procedures and review are determined by the CBK regulation.</p> <p>8. The CBK will maintain statistics on complaints which receives from policyholders.</p>	<p>osiguratelju na ponovno razmatranje. CBK u okviru svojih nadzornih ovlašćenja, procenjuje da li osiguratelj primenjuje najbolje prakse, stručna pravila, zahteve zakona i uslove ugovora o osiguranju.</p> <p>7. Postupci i razmatranje žalbe u CBK se određuju uredbom.</p> <p>8. CBK će držati statistike o primljenim žalbama od osiguranika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 55</b> <b>Zgjidhja e mosmarrëveshjeve</b></p> <p>1. Siguruesi harton dhe miraton procedura të brendshme të përshtatshme, që do të zbatohen nga siguruesi në rastet kur palët bien dakord që mosmarrëveshjet ndërmjet të siguarve apo klientëve me siguruesin apo ndërmjetësuesit të zgjidhen në mënyrë jashtë gjyqësore.</p> <p>2. Siguruesi publikon informacionin për rregullat e zgjidhjes jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve, si pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit.</p> <p>3. Në rastet e lindjes së mosmarrëveshjes për shkak të paqartësive të krijuara nga gjuha e përdorur në hartimin e kushteve të kontratës së</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 55</b> <b>Settlement of Disputes</b></p> <p>1. The Insurer designs and adopts appropriate internal procedures to be applied by the insurer in cases where the parties agree that disputes between the insured and the insurer or intermediary clients must be resolved out of court.</p> <p>2. The insurer publishes information on the rules of out of court settlement of disputes as part of the terms of the insurance contract.</p> <p>3. In cases of disagreement due to uncertainties created by the language used in drafting of the terms of the insurance contract drafted by the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 55</b> <b>Rešavanje sporova</b></p> <p>1. Osiguratelj izrađuje i usvaja prikladne interne postupke koji se primenjuju od strane osiguratelja u slučajevima kada se stranke slažu da se sporovi između osiguranika ili klijenata i osiguratelja ili posrednika rešavaju van suda.</p> <p>2. Osiguratelj objavljuje informaciju o pravilima rešavanja sporova van suda, kao deo uslova ugovora o osiguranju.</p> <p>3. U slučaju nesuglasica zbog neizvesnosti nastalih zbog korišćenog jezika tokom priprema uslova ugovora o osiguranju</p>

<p>sigurimit të hartuara nga siguruesi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet duke interpretuar kushtet në favor të të sigurvearit.</p> <p>4. BQK-ja mund të kërkojë krijimin e një forumi arbitrazhi për zgjidhjen e kontesteve midis të sigurvearit dhe siguruesit dhe procedurat e këtij arbitrazhi mund t'i përcaktojë me rregullore.</p> <p><b>KAPITULLI X</b> <b>KONFIDENCIALITETI PROFESIONAL</b></p> <p><b>Neni 56</b> <b>Konfidencialiteti</b></p> <p>Siguruesi dhe ndërmjetësuesit janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të sigurvearit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.</p> <p><b>Neni 57</b> <b>Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit</b></p> <p>1. Aksionarët, bordi i drejtorëve, menaxherët e lartë, të punësuarit dhe çdo punonjës i sigurvearit, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre përdorin të dhënat konfidenciale, nuk duhet t'ia japë ato palëve të treta, t'i përdorë kundër interesave të sigurvearit</p>	<p>insurer, the resolution of disputes will be by interpreting the conditions in favor of the insured.</p> <p>4. The CBK may require the creation of a forum of arbitration to resolve disputes between the insured and the insurer and the arbitration procedures may be determined by a regulation.</p> <p><b>CHAPTER X</b> <b>PROFESSIONAL CONFIDENTIALITY</b></p> <p><b>Article 56</b> <b>Confidentiality</b></p> <p>The Insurers and brokers are required to maintain the confidentiality of data, facts and circumstances related to the insured, which are known in the exercise of their activity.</p> <p><b>Article 57</b> <b>The Obligation to maintain confidentiality</b></p> <p>1. Shareholders, Board of Directors, senior managers, employees and any employee of the insurer, who in the exercise of their operations use confidential information, should not give them to third parties, to use against the interests of insurers and its clients or allow</p>	<p>sačinjenog od osiguratelja, rešavanje sporova će biti kroz tumačenje uslova u korist osiguranika.</p> <p>4. CBK može zahtevati osnivanje jednog foruma arbitraže za rešavanje sporova između osiguranika i osiguratelja i postupci ove arbitraže se mogu odrediti uredbom.</p> <p><b>POGLAVLJE X</b> <b>STRUČNA POVERLJIVOST</b></p> <p><b>Član 56</b> <b>Poverljivost</b></p> <p>Osiguratelj i posrednici su dužni da čuvaju poverljivost podataka, činjenica i okolnosti vezanih za osiguranika, podaci sa kojima su upoznati tokom vršenja njihove delatnosti.</p> <p><b>Član 57</b> <b>Obaveza čuvanja poverljivosti</b></p> <p>1. Deoničari, Upravni odbor, viših upravnici, zaposleni i bilo koji zaposleni u osiguratelju, koji tokom vršenja njihove delatnosti koriste poverljive informacije, ne bi trebalo da ih daju trećim stranama, koriste protiv interesa osiguratelja i njegovih klijenta ili dozvole</p>
---	--	---

<p>dhe klientëve të saj apo të mundësojë përdorimin e tyre nga palë të treta.</p> <p>2. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet nëse:</p> <p>2.1. i siguruari e miraton shprehimisht me shkrim nxjerrjen e tyre;</p> <p>2.2. të dhënat kërkohen në procese gjyqësore dhe një kërkesë e tillë është bërë me shkrim nga gjykata kompetente;</p> <p>2.3. të dhënat kërkohen në procese hetimore nga organi i Prokurorisë;</p> <p>2.4. në rastet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;</p> <p>2.5. informacioni kërkohet nga BQK-ja me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të saj;</p> <p>2.6. informacioni kërkohet nga organet tatimore;</p> <p>2.7. informacioni jepet sipas dispozitave të Ligjit “për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia”</p>	<p>their use by third parties.</p> <p>2. The obligation of confidentiality shall not apply if:</p> <p>2.1. the insured in writing expressly approved their issuance;</p> <p>2.2. the information is required in criminal proceedings and such a request is made in writing by a competent court;</p> <p>2.3. the information is required in investigations by the Prosecutor;</p> <p>2.4. in the cases provided for in laws and regulations to prevent money laundering and financing of terrorism;</p> <p>2.5. the information is required by the CBK in order to exercise supervision within its competence;</p> <p>2.6. the information is required by tax authorities;</p> <p>2.7. the information is provided under the Law on Compulsory Motor Insurance Liability.</p>	<p>njihovu upotrebu od strane trećih lica.</p> <p>2. Obaveza čuvanja poverljivosti se ne primenjuje ako:</p> <p>2.1. osiguranik izričito pismeno odobri njihovo izdavanje;</p> <p>2.2. podaci se zatraže sudskim postupcima i takav zahtev je vršen pismeno od strane nadležnog suda;</p> <p>2.3. podaci se zatraže tokom istraga od strane organa Tužilaštva;</p> <p>2.4. u predviđenim slučajevima u zakonskim i podzakonskim aktima za sprečavanje pranja novca i finansiranje terorizma;</p> <p>2.5. informacija se zahteva od CBK u cilju nadzora u okviru svoje nadležnosti;</p> <p>2.6. informacija se zahteva od strane poreskih vlasti;</p> <p>2.7. informacija se daje u skladu sa Zakonom "o obaveznom osiguranju od auto-odgovornosti".</p>
--	---	---



<p>3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe pasi personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni largohen nga siguruesi me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2. të këtij neni.</p> <p>4. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për ndërmjetësuesit në sigurime dhe profesionistëve tjerë në sigurime.</p> <p>5. BQK-ja dhe organet tjera të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, i përdorin informacionet konfidenciale, vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë ato informacione.</p>	<p>3. The obligation of confidentiality applies even after the persons mentioned in paragraph 1 of this Article are removed by the insurer except in cases provided for in paragraph 2 of this article.</p> <p>4. The obligation of confidentiality shall also apply to insurance intermediaries and other professionals in insurance.</p> <p>5. The CBK and other bodies referred to in paragraph 1 of this article, use confidential information only for the purposes for which they were given the information.</p>	<p>3. Obaveza çuvanja poverljivosti primenjuje se i nakon što navedena lica iz stava 1. ovog člana napuste osiguratelja, osim u slučajevima predviđenim u stavu 2. ovog člana.</p> <p>4. Obaveza çuvanja poverljivosti se primenjuje i kod posrednika u osiguranju i drugim stručnjacima u osiguranju.</p> <p>5. CBK i drugi organi iz stava 1. ovog člana, koriste poverljive informacije samo u svrhe za koje su date te informacije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 58</b> <b>Mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 58</b> <b>The Collection, Storage and Use of Personal Data</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 58</b> <b>Prikupljanje, čuvanje i korišćenje ličnih podataka</b></p>
<p>1. Siguruesi mbledh, ruan dhe përdor të dhënat personale, të cilat janë të nevojshme për nënshkrimin e policave të sigurimit dhe për zgjidhjen e ankesave, që rrjedhin nga çdo çështje sigurimi sipas këtij Ligji, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>2. Siguruesi krijon, ruan dhe mirëmban bazat e të dhënave:</p> <p>2.1. për personat e siguruar;</p>	<p>1. The insurer collects, stores, and uses personal data, which are required to sign insurance policies and for resolving complaints arising from any insurance issues under this Law, in accordance with the Law on Personal Data Protection.</p> <p>2. Insurer creates, preserves, and maintains databases:</p> <p>2.1. for insured persons;</p>	<p>1. Osiguratelj prikuplja, čuva, koristi lične podatke koji su potrebni za potpisivanje polisa osiguranja i za rešavanje žalbi koje proizilaze iz bilo kakvih pitanja osiguranja u skladu sa ovim Zakonom, u skladu sa Zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>2. Osiguratelj stvara, čuva i održava bazu podataka:</p> <p>2.1. za osigurana lica;</p>

<p>2.2. për dëmet e ndodhura;</p> <p>2.3. për vlerësimin e mbulimit të sigurimit dhe shumat e dëmshpërblimit.</p>	<p>2.2. for claims incurred;</p> <p>2.3. for assessment of insurance coverage and compensation amounts.</p>	<p>2.2. za nastale štete;</p> <p>2.3. za procenu pokrića osiguranja i iznose obeštećenja.</p>
<p><b>KAPITULLI XI</b> <b>MENAXHIMI I RREZIKUT</b></p>	<p><b>CHAPTER XI</b> <b>RISK MANAGEMENT</b></p>	<p><b>POGLAVLJE XI</b> <b>UPRAVLJANJE RIZIKOM</b></p>
<p><b>Neni 59</b> <b>Rregullat e menaxhimit të rrezikut</b></p>	<p><b>Article 59</b> <b>Risk management rules</b></p>	<p><b>Član 59</b> <b>Pravila upravljanja rizikom</b></p>
<p>1. Siguruesi është i detyruar që ta mbajë nivelin e kapitalit në vëllimin përkatës në raport me rreziqet e ndërmarra.</p> <p>2. Siguruesi është i detyruar të bëjë afarizëm në atë mënyrë që rreziqet të cilave u ekspozohet në punë të veçanta, përkatësisht në të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të cilat i ushtron, të mos i tejkalojnë vlerat ose kufijtë e paraparë me këtë Ligj, si edhe me dispozitat e miratuara në bazë të tij.</p> <p>3. Siguruesi është i detyruar që të bëjë afarizëm në atë mënyrë që të jetë e aftë që t’i përmbushë me kohë detyrimet e arritura (parimi i likuiditetit), në atë mënyrë që të jetë vazhdimisht e aftë për t’i përmbushur të gjitha detyrimet (parimi i solventitetit – aftësisë për pagesë).</p>	<p>1. The insurer is obligated to maintain the level of capital in an adequate volume to undertaken risks ratio.</p> <p>2. The insurer is obligated to do business in a way that risks to which it is exposed in specific jobs, respectively in all insurance activities, which exercises, do not exceed the values or limits prescribed by this Law, as well as regulations adopted under it .</p> <p>3. The insurer is required to do business in a way to be able to meet its accepted liabilities on timely manner (the principle of liquidity), in order to be able to consistently meet all obligations (principle of solvency - the ability to pay).</p>	<p>1. Osiguratelj je dužan da održava nivo kapitala u odgovarajućem obimu u odnosu na preduzete rizike.</p> <p>2. Osiguratelj je dužan da posluje na način koji rizicima izložena određenim poslovima, odnosno u svim radnjama osiguranja, koje vrši, ne prelazi vrednosti ili ograničenja propisana ovim Zakonom, kao i sa propisima usvojenih na njegovu osnovu.</p> <p>3. Osiguratelj je obavezan da posluje na način na koji treba da bude u stanju da ispuni blagovremeno svoje ostvarene obaveze (princip likvidnosti), kako bi bilo u stanju da neprekidno vrši sve obaveze (princip solventnosti-tj. sposobnost isplate).</p>

<p>4. Siguruesi harton dhe miraton politika e procedura të qarta dhe të hollësishme për identifikimin, matjen, monitorimin dhe parandalimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë.</p>	<p>4. The insurer designs and adopts policies and procedures which are clear and detailed for identifying, measuring, monitoring and prevention of risks to which may be exposed during the exercise of operations.</p>	<p>4. Osiguratelj izrađuje i usvaja jasne i detaljne politike i postupke za identifikovanje, merenje, nadgledanje i sprečavanje rizika, prema kojima se izlaže tokom vršenja delatnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 60</b> <b>Kapitali i siguruesit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 60</b> <b>Capital Providers</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 60</b> <b>Kapital osiguratelja</b></p>
<p>1. Çdo sigurues ose risigurues obligohet të mirëmbaj nivelin minimal të kapitalit, e që duhet të jetë adekuat për llojet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të tij sigurues dhe në përputhje me rreziqet ndaj të cilëve iu është ekspozuar. Llogaritja e kapitalit të siguruesit, përcaktohet me rregullore të veçantë të kërkuara nga BQK-ja.</p>	<p>1. Every insurer is required to maintain a minimum level of capital, which should be adequate for the type and scope of its insurer activities in accordance with the risks to which it is exposed. The calculation of the insurer's capital is determined by a special regulations issued by the CBK.</p>	<p>1. Svaki osiguratelj je dužan da održava minimalni nivo kapitala, koji treba da bude adekvatan za vrstu i delokrug svojih aktivnosti osiguranja i u skladu sa rizicima kojima je izložen. Obračun kapitala osiguratelja se određuje posebnom uredbom izdatoj od strane CBK-a.</p>
<p>2. BQK-ja përcakton nivelin minimal të kapitalit për siguruesit, dhe metodat e llogaritjes, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), përfshirë këtu parimet e nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimit (IAIS).</p>	<p>2. The CBK establishes a minimum level of capital for insurers, and methods of calculation, taking into account International Accounting Standards (IAS), including principles issued by the International Association of Insurance Supervisors (IAIS).</p>	<p>2. CBK određuje minimalni nivo kapitala za osiguratelja, kao i metode obračuna, uzimajući u obzir međunarodne računovodstvene standarde (MRS), uključujući i izdata načela od strane Međunarodnog Udruženja Nadzornika Osiguranja (IAIS).</p>
<p>3. BQK-ja mund të urdhërojë siguruesin që të rritë kapitalin e tij në nivelin e kërkuar, duke marrë për bazë numrin e klasave të sigurimit dhe ekspozimin ndaj rrezikut nga siguruesi. Për</p>	<p>3. The CBK may order the insurer to increase its capital to the required level, taking into account the number of classes of insurance and risk exposure of the insurer. For each</p>	<p>3. CBK može narediti osiguratelju da poveća svoj kapital na zahtevani nivo, uzimajući u obzir broj klasa osiguranja i izloženost riziku od osiguratelja. Za svaku dodatnu klasu</p>

<p>çdo klasë shtesë të sigurimit, kompanisë mund t'i kërkohej të shtojë kapital shtesë, ashtu siç do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga BQK-ja.</p>	<p>additional class of insurance, the company may be required to add additional capital, as shall be determined by special regulations by CBK.</p>	<p>osiguranja, od kompanije se može zahtevati da doda dodatni kapital, što će biti propisano posebnom uredbom od strane CBK-a.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 61</b> <b>Llogaritja e kapitalit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 61</b> <b>Calculation of Capital</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 61</b> <b>Obračun kapitala</b></p>
<p>1. Çdo sigures mban një nivel të kapitalit që është adekuat për llojet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të tij sigures dhe në përputhje me rreziqet ndaj të cilëve është ekspozuar.</p>	<p>1. Every insurer maintains a level of capital which is adequate for the type and scope of its insurer activities, in accordance with the risks to which it is exposed.</p>	<p>1. Svaki osiguratelj je dužan da održava minimalni nivo kapitala, koji treba da bude adekvatan za vrstu i delokrug svojih aktivnosti osiguranja i u skladu sa rizicima kojima je izložen.</p>
<p>2. Me qëllim të zbatimit të rregullave për menaxhimin e rrezikut, kapitali i siguresit (më tutje "kapitali") llogaritet duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe kontabilitetit, përfshirë këtu parimet e nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimit.</p>	<p>2. In order to implement the rules on risk management, capital providers (hereinafter "capital") is calculated by taking into account International Standards of Accounting, including principles issued by the International Association of Insurance Supervisors.</p>	<p>2. U cilju primene pravila o upravljanju rizicima, kapital osiguratelja (u daljem tekstu "kapital") se obračunava uzimajući u obzir međunarodne standarde knjigovodstva, uključujući i principe izdate od strane Međunarodnog Udruženja Nadzornika Osiguranja.</p>
<p>3. Siguresi gjatë gjithë aktivitetit sigures, duhet të mirëmbajë nivelin minimal të kapitalit të kërkuar, margjinës minimale të aftësisë paguesesolvencës dhe të likuiditetit.</p>	<p>3. Throughout insurance activity the insurer must maintain a minimum level of required capital, minimum solvency and liquidity margins.</p>	<p>3. Osiguratelj tokom aktivnosti osiguranja, treba održavati minimalni nivo zahtevanog kapitala, minimalne margine sposobnosti isplate tj. solventnosti i likvidnosti.</p>
<p>4. Aftësia paguese (solvenca) përcaktohet si totali i aseteve, duke zbritur asetet e papranueshme dhe totalin e detyrimeve, përjashtuar kapitalin minimal.</p>	<p>4. The payment capability (solvency) is defined as total of assets, subtracting unacceptable assets and total liabilities, excluding capital requirement.</p>	<p>4. Sposobnosti isplate (solventnost) se određuje kao ukupna aktiva, oduzimajući neprihvatljive aktive i ukupnu pasivu, isključujući minimalni kapital.</p>
<p>5. BQK-ja me rregullore të veçantë, përcakton</p>	<p>5. The CBK regulations will determine the</p>	<p>5. CBK posebnom uredbom određuje metod</p>

<p>mënyrën e llogaritjes së ekuitetit, margjinës minimale të solvencës dhe treguesve të tjerë të likuiditetit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 62</b> <b>Niveli i kërkuar i aftësisë paguese</b></p> <p>1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit, që i kryen punët e sigurimeve në grupin e sigurimeve jo jetë, është i detyrueshëm të jetë i njëjtë me kufirin e solventitetit të përlllogaritur në bazë të raportit të primeve, përkatësisht të dëmeve, cilado që është më e lartë.</p> <p>2. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese (solvencës) për siguruesit që ushtrojnë aktivitet sigurimi gjatë gjithë aktivitetit sigurues, nuk duhet të jetë më i ultë se niveli minimal i kërkuar për aftësi paguese të siguruesit, e vendosur nga BQK-ja.</p> <p>3. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit që ushtron veprimtari në klasat e sigurimit jetë, mund të llogaritet siç përcaktohet me rregullore të veçantë, të lëshuar nga BQK-ja.</p> <p>4. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesit, që ushtron veprimtari sigurimi në klasat e jetës, llogaritet si shuma totale e</p>	<p>equity method of accounting the minimum margin of solvency and other liquidity indicators.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 62</b> <b>The Required Solvency</b></p> <p>1. The required solvency of the insurer, which conducts insurance activities in the group of non-life insurance is required to be the same as the limit of solvency calculated based on the ratio of premiums, respectively claims, whichever is higher.</p> <p>2. The required solvency (solvency) for insurers which operate throughout the course of the insurer's activities should not be lower than the minimum solvency required from the insurers, set by the CBK.</p> <p>3. The required solvency margin of the insurer which carries out life insurance classes, can be calculated as defined by a special regulations issued by the CBK.</p> <p>4. The required solvency margin of the insurer, which carries life insurance activity, is calculated as the total sum of the results</p>	<p>obračunavanja ekviteta (deoničarskog kapitala), minimalne margine solventnosti i ostalih pokazatelja likvidnosti.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 62</b> <b>Zahtevani nivo sposobnosti isplate</b></p> <p>1. Zahtevani nivo sposobnosti isplate osiguratelja koji obavlja osiguranje u grupi neživotnih osiguranja je obavezan da bude isti sa granicom obračunate solventnosti na osnovu odnosa premija, odnosno šteta, bez obzira koja je veća.</p> <p>2. Zahtevani nivo sposobnosti isplate (solventnost) za osiguratelje koji vrše osiguranje tokom aktivnosti u osiguranju, ne treba da bude niži od minimalno zahtevanog nivoa isplate osiguratelja, postavljenog od strane CBK.</p> <p>3. Zahtevani nivo sposobnosti isplate osiguratelja koji obavlja aktivnost u klasama životnog osiguranja, može se izračunati kao što je definisano sa posebnom uredbom izdatom od strane CBK.</p> <p>4. Zahtevani nivo sposobnosti isplate osiguratelja koji obavlja aktivnost u klasama životnog osiguranja, izračunava se kao ukupan</p>
---	--	---

<p>rezultateve të përfituara nga metodat e përdorura. Metodatat dhe mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për siguruesin, që ushtron veprimtari në klasat e jetës, përcaktohen nga BQK-ja me rregullore.</p>	<p>obtained by the methods used. Methods and ways of calculating the required level of solvency for the insurer that operates in life insurance classes, is defined by the CBK regulations.</p>	<p>iznos dobijenih rezultata korišćenih metoda. Metode i načini izračunavanja zahtevanog nivoa sposobnosti isplate za osiguratelja koji obavlja aktivnost u klasama života, se određuju uredbom od CBK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 63</b> <b>Plani i rimëkëmbjes financiare</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 63</b> <b>Financial Recovery Plan</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 63</b> <b>Plan finansijskog oporavka</b></p>
<p>1. Në rast të rrezikimit të të drejtave të siguruarve, BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi, plan financiar me masa të propozuara deri në maksimum tri vite, për rimëkëmbje financiare, e që duhet të përmbajë, por duke mos u kufizuar vetëm në:</p> <p>1.1. vlerësimin e shpenzimeve të menaxhmentit, përkatësisht të shpenzimeve të menaxhimit, si edhe krahasimin me shpenzimet e tërësishme dhe me provizionet;</p> <p>1.2. vlerësimin e hollësishëm të të hyrave dhe të dalave nga punët e drejtpërdrejta të sigurimeve;</p> <p>1.3. pasqyrat financiare të projektuara;</p> <p>1.4. vlerësimin e mjeteve të nevojshme financiare për arritjen e baraspeshës së kapitalit dhe të mbulesës së të gjitha</p>	<p>1. In case of violation of rights of the insured, the CBK may require from the insurer , a maximum three year financial plan with proposed measures, for financial recovery, which should include, but not limited to:</p> <p>1.1. evaluation of management expenses, managing expenses, respectively, as well as the comparison with the total costs and provisions;</p> <p>1.2. detailed assessment of revenues and costs from direct jobs insurance affairs;</p> <p>1.3. projected financial statements,;</p> <p>1.4. assessment of the financial means needed to achieve the balance of capital and cover all of the insurer liabilities;</p>	<p>1. U slučaju povrede prava osiguranika, CBK može da zahteva od osiguratelja finansijski plana sa predloženim merama za maksimum naredne tri godine, za finansijski oporavak, šta treba da sadrži, ali ne ograničavajući se na:</p> <p>1.1. procenu troškova upravljanja, odnosno troškove upravljanja, kao i poređenje sa ukupnim troškovima i provizijama;</p> <p>1.2. detaljnu procenu prihoda i rashoda iz direktnih aktivnosti osiguranja;</p> <p>1.3. projektovane finansijske izveštaje;</p> <p>1.4. procenu potrebnih finansijskih sredstava za postizanje ravnoteže kapitala i pokrića svih obaveza osiguratelja;</p>

<p>detyrimeve të siguruesit;</p> <p>1.5. politikën e risigurimit.</p> <p>2. BQK-ja mund të kërkojë kapital më të madh sesa ai i paraparë me dispozita të këtij Ligji, në qoftë se e vlerëson se për shkak të pozitës së dobësuar financiare të siguruesit, janë rrezikuar të drejtat e të siguruarve. Lartësia e kapitalit caktohet në bazë të planit financiar, bashkë me masat e propozuara.</p> <p>3. BQK-ja mund të kërkojë zvogëlimin e vlerës së pasurisë së siguruesit, e cila përfshihet në përllogaritje të kapitalit të siguruesit, në qoftë se ka ndodhur ndryshimi i vlerës së tregut të asaj pasurie.</p> <p>4. BQK-ja mund të kërkojë përshtatjen e përllogaritjes së kufirit të solventitetit të siguruesit për shumën e risigurimit, në qoftë se të hyrat ose cilësia e kontratës së risigurimit në krahasim me vitin e mëparshëm afarist ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme ose nëse kontratat e risigurimit nuk e bëjnë të mundshëm bartjen e balancuar të rrezikut.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 64</b> <b>Menaxhimi i likuiditetit</b></p> <p>1. Siguruesi menaxhon burimet financiare dhe</p>	<p>1.5. reinsurance policy.</p> <p>2. The CBK may require greater capital than that provided by the provisions of this Law, if it estimates that due to the weakened financial position of insurers, the rights of the insured are jeopardizing. The amount of capital needed is determined based on the financial plan, as well as with the proposed measures.</p> <p>3. The CBK may require lowering the value of the assets of the insurance company, which is included in the calculation of the capital of the insurer, if a change of the market value of the asset has occurred.</p> <p>4. CBK may require adaptation of calculation of the solvency limit of insurers for the amount of reinsurance, if the income or quality of reinsurance contract compared to the previous business years has changed significantly or reinsurance contracts do not make possible the transfer of the balance of risk.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 64</b> <b>Liquidity management</b></p> <p>1. The insurer manages financial resources and</p>	<p>1.5. politiku reosiguranja.</p> <p>2. CBK može da zahteva veći kapital od onog predviđenog prema odredbama ovog Zakona, ukoliko se proceni da se zbog oslabljene finansijske pozicije osiguratelja, ugrožavaju prava osiguranika. Visina kapitala se određuje na osnovu finansijskog plana, zajedno sa predloženim merama.</p> <p>3. CBK može zahtevati smanjenje vrednosti imovine osiguratelja, koja se obuhvata u obračun kapitala osiguratelja, ako je došlo do izmene tržišne vrednosti te imovine.</p> <p>4. CBK može da zahteva prilagođavanje obračunavanja granice solventnosti osiguratelja za iznos reosiguranja ako su se prihodi ili kvalitet ugovora o reosiguranju, u odnosu na prethodnu poslovnu godinu, značajno promenili ili ugovori o reosiguranju ne omogućavaju balansirani prenos rizika.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 64</b> <b>Upravljanje likvidnosti</b></p> <p>1. Osiguratelj upravlja svojim finansijskim</p>
--	---	--

<p>investimet e tij në mënyrë të tillë, që të sigurojë fonde adekuate në çdo kohë për përmbushjen e përgjegjësive kur u vjen afati i pagesës.</p> <p>2. Siguruesi, me qëllim mbrojtjen ndaj rrezikut të likuiditetit, miraton dhe zbaton politika për menaxhimin e likuiditetit, që përfshijnë:</p> <p>2.1. planifikimin e fluksit monetar;</p> <p>2.2. monitorim sistematik të likuiditetit;</p> <p>2.3. zbatimin e masave të përshtatshme për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.</p> <p>3. Siguruesi llogarit shumat e fondeve të likuiditetit, në minimum në baza tremujore.</p> <p>4. Siguruesi llogarit normat e likuiditetit dhe nivelin minimal të tyre mbi bazën e metodave të përcaktuara me rregullore nga BQK-ja.</p>	<p>its investments in a manner as to ensure adequate funding at any time of their responsibilities when payment deadline comes.</p> <p>2. In order to be protected against liquidity risk, the insurer adopts and implements policies to manage liquidity, which includes:</p> <p>2.1. planning of cash flows;</p> <p>2.2. systematic monitoring of liquidity;</p> <p>2.3. implementation of appropriate measures to prevent and eliminate the causes of lack of liquidity.</p> <p>3. The insurer calculates the amounts of liquidity funds at a minimum on a quarterly basis.</p> <p>4. The insurer calculates rates and minimum level of liquidity on the basis of methods prescribed by regulation by the CBK.</p>	<p>sredstvima i investicijama tako što obezbeđuje adekvatna finansijska sredstva u bilo kom trenutku za ispunjavanje svoje odgovornosti kada dođe rok za plaćanje.</p> <p>2. Osiguratelj, u cilju zaštite od rizika likvidnosti, usvaja i sprovodi politike za upravljanje likvidnosti, koje obuhvataju:</p> <p>2.1. planiranje novčanih tokova;</p> <p>2.2. sistematsko nadgledanje likvidnosti;</p> <p>2.3. sprovođenje odgovarajućih mera za sprečavanje i otklanjanje uzroka nelikvidnosti.</p> <p>3. Osiguratelj izračunava iznose sredstava za likvidnost, minimalno na kvartalnoj osnovi.</p> <p>4. Osiguratelj izračunava stope likvidnosti i njihov minimalni nivo na osnovu uredbom propisanih metoda od strane CBK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 65</b> <b>Raportimi në BQK</b></p> <p>1. Siguruesi llogarit dhe dërgon periodikisht:</p> <p>1.1. raportet financiare: Pasqyrën e</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 65</b> <b>Reporting to the CBK</b></p> <p>1. The insurer calculates and sends periodically:</p> <p>1.1. financial Reports: statement of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 65</b> <b>Izveštavanje u CBK</b></p> <p>1. Osiguratelj obračunava i šalje periodično:</p> <p>1.1. finansijske izveštaje: Izveštaj o</p>



